




**MJETET E PRAKTIKUESIT NË KUADËR TË UDHËRRËFYESIT:**

## **DIREKTIVA MBI TË DREJTËN PËR INFORMIM**

**DOKUMENTI I TË DREJTAVE  
E DREJTA PËR INFORMIM MBI AKUZËN  
E DREJTA PËR QASJE NË LËNDËN E RASTIT  
DËSHMITARËT DHE PERSONAT TJERË JO TË  
DYSHUAR**



## Lidhur me Fair Trials

“Fair Trials – Evropë” është një fondacion publik me seli në Bruksel, që punon për gjykime të drejta sipas standardeve të drejtësisë të njohura ndërkombëtarisht. Vizioni ynë është një botë ku respektohet e drejta e çdo personi për një gjykim të drejtë, pavarësisht kombësisë së tyre, kudo që ata akuzohen.

Fair Trials u ndihmon njerëzve të kuptojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre për gjykim të drejtë; adreson shkaqet rrënjësore të padrejtësisë përmes punës së saj të reformës ligjore; dhe zhvillon trajnime të synuara dhe aktivitete të rrjetëzimit për të mbështetur avokatët dhe mbrojtësit e tjerë të të drejtave të njeriut në punën e tyre për të mbrojtur të drejtat për gjykim të drejtë.

Duke punuar me Panelin Këshillëdhënës të Ekspertëve Ligjorë ("LEAP") - një rrjet prej më shumë se 140 ekspertëve të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut, duke përfshirë avokatë mbrojtës, OJQ-të dhe akademikët nga 28 Shtete Anëtare të BE-së –Fair Trials ka kontribuar në negociatat rreth miratimit të tri direktivave sipas Udhërrëfyesit për përforcimin e të drejtave procedurale.

LEAP, i mbështetur nga Fair Trials, tani po angazhohet për të siguruar zbatimin efektiv të Direktivave, në vazhden e strategjisë së saj të, Drejt një Lëvizjeje të BE-së për të Drejtat e Mbrojtjes, të shkurtit të vitit 2015, duke përfshirë trajnimin e praktikuesve, proceset gjyqësore pranë gjykatave kombëtare, ngritjen e vetëdijes.

## Kontakti

### LibbyMcVeigh

Drejtor për çështje ligjore dhe politika

FairTrialsInternational

+44(0)2078222370

[libby.mcveigh@fairtrials.net](mailto:libby.mcveigh@fairtrials.net)

### AlexTinsley

Zyrtar i çështjeve ligjore dhe politika

FairTrialsEurope

+32(0)27438593

[alex.tinsley@fairtrials.net](mailto:alex.tinsley@fairtrials.net)

## Falënderimet

Fair Trials dëshiron të falënderojë anëtarët e LEAP dhe të pranishmit e tjerë në mbledhjet e tryezës së ekspertëve, për të siguruar informacione mbi të cilat bazohet ky Udhëzues. Ne gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë ish-kolegët e Fair Trials, Vera Padberg dhe Maeve Keenan për kontributin e tyre në këtë dokument.

Me ndihmën financiare nga:



**Bashkë financiar nga Programi i  
Drejtësisë Penale i Komisionit Evropian**



## PËRMBAJTJA

### Përmbajtja

<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
A. HYRJE .....	6
1. Historiku dhe materialet tjera trajnuese të FairTrials/LEAP .....	6
2. Fushëveprimi i këtij manuali .....	7
3. Si të përdoret ky manual .....	7
a. Si është e organizuar përmbajtja.....	7
b. Manuali ‘Përdorimit të së Drejtës së BE-së në Praktikë’ .....	8
c. Kini kujdes.....	8
d. Mbani kontakte.....	8
B. PARA DIREKTIVËS:PERMBLEDHJA E PARIMEVE TË GJEDNJ .....	8
C. PËRMBLEDHJE E DIREKTIVËS .....	10
1. Pasqyrim i shkurtër.....	10
2. Qëllimi dhe objektivat .....	14
D. PUNA PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E DIREKTIVËS .....	15
1. Kontrolloni ligjin dhe praktikën kombëtare nga pikëpamja e Direktivës.....	15
2. Bisedoni me kolegët/odat e avokatëve .....	16
<b>I - NJOFTIMI I TË DYSHUARVE ME TË DREJTAT E TYRE .....</b>	<b>17</b>
A. ÇËSHTJA.....	17
B. BAZA E GJEDNJ-së .....	18
C. DISPOZITAT RELEVANTE TË DIREKTIVËS .....	19
1. Fushëveprimi i obligimit për njoftim .....	19
2. Njoftimi i të drejtave .....	20
a. Njoftimi mbi të drejtat i gjithë personave të dyshuar dhe të akuzuar .....	20
3. Njoftimi i të drejtave– personat e arrestuar .....	21
D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	22
1. Pika paraprake: Direktiva rregullon çështjen e njoftimit, por jo edhe të drejtat aktuale .....	22
1. Marrja e veprimeve në momentin e njoftimit(nëse jeni aty) .....	22
a. Gjatë asistimit të dyshuarit .....	22
b. Gjatë asistimit të dëshmitarit i cili bëhet i dyshuar .....	24
2. Ankimimi kundër mos-njoftimit me të drejtat .....	24
a. Rasti paradigmë .....	24
b. Përcaktoni se si njoftimi ka qenë i paefektshëm .....	24
i. Forma dhe gjuha.....	24
ii. Koha e njoftimit .....	25
iii. Njoftimi i dekurajues (zhbindës) .....	26

c.	Dokumentoni shkeljen .....	26
d.	Vërtetimi i "cenimit" .....	27
e.	Thirruni në Direktivë dhe rendisni argumentet tuaja .....	27
<b>PJESA II - NJOFTIMI I ARSYEVE PER ARRESIN /AKUZËN .....</b>	<b>27</b>	
A.	ÇËSHTJA.....	27
B.	BAZA E KEDNJ-së .....	27
C.	DISPOZITAT E RËNDËSISHME TË DIREKTIVËS .....	30
D.	PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	31
1.	Identifikoni mangësinë në njoftimin e akuzave .....	31
a.	Dështimi për klasifikim të veprës .....	31
b.	Nënklasifikimi në pikën e marrjes në pyetje.....	31
c.	Mos-specifikimi i mjaftueshëm i akuzave faktike .....	32
2.	Kërkoni informata në pikën e marrjes në pyetje dhe krijoni një dosje .....	32
3.	Kundërshtimi i shkeljes .....	34
a.	Inkurajimi i veprimeve në instancën e paraburgimit.....	34
b.	Thirruni në Direktivë dhe kërkoni ushtrimin e mjetit ligjor për njoftimin joadekuat .....	34
<b>III - QASJA NË DOSJEN E LËNDËS.....</b>	<b>36</b>	
A.	ÇËSHTJA.....	36
B.	BAZA E KEDNJ-së .....	36
1.	Qasja në dosjen e lëndës në fazën e procedurës paraprake .....	36
2.	Qasja në dosjen e lëndës për tu përgatitur për gjykim .....	38
C.	DISPOZITAT PËRKATËSE TË DIREKTIVËS .....	39
D.	PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	41
1.	Qasja në dosjen e lëndës në fazën e marrjes në pyetje .....	41
a.	Debati lidhur me kërkesat e nenit 7(1).....	41
b.	Pikëpamja e "Fair Trials": neni 7(1) kërkon qasje në momentin e marrjes në pyetje ...	41
2.	Qasja në dosjen e lëndës dhe shqyrtimi efektiv gjyqësor i arrestimit/paraburgimit .....	43
a.	Pika fillestare: neni 7(1) nuk i nënshtrohet asnjë derogimi .....	44
b.	Kundërshtimi i kufizimit ligjor të qasjes .....	44
c.	Kundërshtimi i kufizimit "prokurori vendos" .....	44
3.	Qasja në dosjen e lëndës në fazën e procedurës paraprake - pavarësisht nga paraburgimi .....	46
a.	Mangësia në praktikën gjyqësore të KEDNJ-së.....	46
b.	Pikëpamja e "Fair Trials": Neni 7(2) kërkon qasje gjatë procedurës paraprake, duke iu nënshtroar zbatimit të përjashtimeve të verifikueshme gjyqësore .....	46
4.	Qasja në dosjen e lëndës për tu përgatitur për gjykim .....	48
<b>IV - DËSHMITARËT DHE PERSONAT TJERË JO TË DYSHUAR .....</b>	<b>49</b>	
A.	ÇËSHTJA.....	49
B.	BAZA E KEDNJ-së .....	49
1.	Koncepti i të qenit i "akuzuar" .....	49

2.	Dëshmitarët që janë/bëhen të dyshuar .....	49
C.	DISPOZITAT RELEVANTE TË DIREKTIVËS .....	50
D.	PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	51
1.	Pika paraprake: fushëveprimi i dukshëm i kufizuar i direktivës.....	51
a.	Formulimi i nenit 2 .....	51
b.	Pikëpamja e “Fair Trials” lidhur me fushëveprimin e direktivës.....	52
2.	Përcaktimi i shkeljes.....	52
3.	Shqyrtoni ushtrimin e një mjeti ligjor .....	54
<b>PËRFUNDIM.....</b>		<b>55</b>

# HYRJE

## A. HYRJE

### 1. Historiku dhe materialet tjera trajnuese të FairTrials/LEAP

---

Në dekadën e fundit, Shtetet Anëtare të BE-së kanë bashkëpunuar ngushtë lidhur me çështjet ndërkufitare, kryesisht nëpërmjet Urdhrit Evropian të Arrestit. Sistemet e tilla mbështeten në besimin e ndërsjellë midis autoriteteve gjyqësore që secila do të respektojë të drejtat e atyre që janë në fjalë, në veçanti siç garantohet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('**KEDNJ**').

Megjithatë, bashkëpunimi është dëmtuar nga fakti se autoritetet gjyqësore nga të cilat kërkohet që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën, në realitet nuk kanë besim të plotë tek njëra tjetra sa i përket përmbushjes së këtyre standardeve. Me qëllim të përfundimit të sistemit, BE ka filluar vendosjen e standardeve minimale për të rregulluar aspekte të caktuara të procedurës penale përmes një programi të quajtur '**Udhërrëfyesi**')<sup>1</sup>. Përderisa këto masa kanë origjinën e tyre në sigurimin e besimit të ndërsjellë, si rezultat kemi një sërë direktivash që detyrojnë autoritetet kombëtare në të gjitha rastet, duke përfshirë ato që nuk e kanë elementin ndërkufitar. Këto mbulojnë të drejtën e interpretimit dhe përkthimit,<sup>2</sup> të drejtën për informim<sup>3</sup>, dhe të drejtën e qasjes në avokat<sup>4</sup> (kolektivisht të quajtura si '**Direktivat**').

Masa e diskutuar në këtë udhëzues është Direktiva 2012/13/BE për të Drejtën në Informim në Procedurë Penale ("**Direktiva**"), e cila është dashur të transpozohet në ligjin vendor deri më datën 2 qershor 2014. Masa rregullon të drejtën e të dyshuarit për t'u informuar në lidhje me të drejtat e tij procedurale, për t'u informuar lidhur me akuzat për të cilat ai akuzohet dhe për të pasur qasje në lëndën dhe materialet e rastit. Ky manual duhet të lexohet së bashku me videon e trajnimit online të prodhuar nga Fair Trials.<sup>5</sup>

Çështja e të drejtës për informim, veçanërisht në lidhje me mënyrën dhe kohën e njoftimit për të drejtat procedurale ndaj të dyshuarve, ka marrë më pak vëmendje në praktikën gjyqësore dhe trajnimin për praktikuesit, se sa për të drejtën e qasjes në avokat dhe Direktiva i qartëson këto mbrojtje të rëndësishme.

Në mënyrë që Direktiva të arrijë qëllimin e saj, Direktiva duhet të thirret nga avokatët në raste individuale për të siguruar që gjykatat të respektojnë standardet e saj. Ky Udhëzues është hartuar për t'ju dhënë këshilla praktike se si të përdoret Direktiva në praktikë. Duhet të lexohet së bashku me manualin e "Përdorimit të drejtës së BE në Praktikën Penale" dhe videon e trajnimit online në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> Rezoluta e Këshillit, e datës 30 Nëntor 2009, mbi Udhëzuesin për forcimin e të drejtave të të dyshuarve ose personave të akuzuar në procedura penale ([OJ2009C295.p.1](#))

<sup>2</sup> Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 Tetor 2010 për të drejtën në interpretim dhe përkthim në procedura penale ([OJ 2010 L 280, p. 1](#))

<sup>3</sup> Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 22 Maj 2012, mbi të drejtën për informim në procedura penale ([OJ2012L142.p.1](#))

<sup>4</sup> Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 22 Tetor 2013, mbi të drejtën e qasjes në avokatë në procedura penale dhe në procedurat e Urdhrit Evropian të Arrestit, si dhe mbi të drejtat për të informuar palët e treta pas privimit nga liria dhe për të komunikuar me personat e tretë dhe me autoritetet konsullore derisa janë të privuar nga liria ([OJ2013L290.p.1](#))

<sup>5</sup> Në dispozicion në vegzën: <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/online-training/>.

<sup>6</sup> Në dispozicion në vegzën: <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/>.

## 2. Fushëveprimi i këtij manuali

Ky Manual nuk është gjithëpërfshirës. Ai mbulon çështje të caktuara të cilat janë potencuar nga anëtarët e rrjetit LEAP si një sfidë që përbëjnë një sfidë të veçantë për realizimin e mbrojtjes penale. Këto çështje përfshijnë: (I) Njoftimin e të drejtave procedurale; (II) Njoftimin e Akuzimeve; (III) Qasjen në lëndën e rastit në faza të caktuara; dhe (IV) zbatimin e Direktivës ndaj dëshmitarëve dhe personave tjerë jo të dyshuar.

Shumë çështje të tjera mund të ngritën. Për shembull, në kohën e shkrimit, një referencë<sup>7</sup> është në pritje përpara se GJED të pyesë nëse Direktiva e përjashton një rregull të së drejtës kombëtare që kërkon që një person të caktojë një person për shërbimin e dokumenteve, kur një afat kohor i ankesës zhvillohet nga ky shërbim. Ka shumë pyetje të tjera potenciale, kështu që ne ju inkurajojmë ta trajtoni këtë Udhëzues vetëm si pikë fillestare.

## 3. Si të përdoret ky manual

### a. Si është e organizuar përmbajtja

Pjesa më e madhe e përmbajtjes së Direktivës rrjedh nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ('**GJEDNJ**'), dhe nuk ka dyshim se një nga funksionet kryesore të Direktivës është artikulli i këtyre standardeve si norma të kodifikuara. Prandaj, për secilën fushë tematike, Udhëzuesi shqyrton jurisprudencën e GJEDNJ-së për t'ju ndihmuar të kuptoni çështjet që artikulon Direktiva.

Ne pastaj i marrim parasysh dispozitat e vetë Direktivës. Shumica e dispozitave të Direktivave lënë hapësirë të konsiderueshme për interpretim, dhe në kohën kur është përpiluar<sup>8</sup> ende nuk ka ndonjë vendim të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë ("GjEND") në ndonjë prej Direktivave. Prandaj, përpiqemi ta bëjmë të qartë - duke përdorur pikat kryesore në boshtin e tekstit - nëse bëjmë ndonjë supozim rreth kuptimit të tyre.

Bazuar në kuptimin tonë të Direktivës, ne pastaj bëjmë sugjerime konkrete se si ta përdorim atë në një rast të caktuar. Këto përfshijnë dy hapa praktikë (p.sh. dokumentimi dhe sfidimi i shkeljeve në fazën paragyqësore) dhe hapat ligjorë (p.sh. thirrja në Direktivë pranë një gjykate). Për të bërë një dallim të qartë në mes të këtyre niveleve të ndryshme të analizës:

*Dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe citimet nga rastet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut janë paraqitur të hijezuara me të verdhë, të kufizuara me një vij të vetme, për të paraqitur natyrën e tyre si minimumi i domosdoshëm. Ato janë të paraqitura me shkrim kursiv.*

Sugjerimet nga Fair Trials mbi përdorimin e Direktivës në praktikë janë paraqitur me hijezim të kaltër, me kufi të trefishtë, për të përfaqësuar përdorimin tuaj të Direktivës në kontekstin lokal ligjor. Ne përpiqemi të jemi një hap para kur bëjmë një sugjerim me simbolin '→'.

Dispozitat e të drejtës së Bashkimit Evropian ose citimet nga praktika gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian janë paraqitur me hijezim të gjelbër, me kufizim të dyfishtë, për të paraqitur natyrën e tyre plotësuese, dhe mundësisht si mbrojtje më e aierë.

<sup>7</sup> Kërkesa për një vendim paraprak nga Amtsgericht Laufen (Gjermani) parashtruar më datë 30 prill 2014 - Procedura penale kundër Gavril Covaci ([OJ2014C253,p.22](#)).

<sup>8</sup> Ky Udhëzues është publikuar në Mars të vitit 2015.

## b. Manuali ‘Përdorimit të së Drejtës së BE-së në Praktikë’

Ky Manual duhet të përdoret së bashku me Manualin “Përdorimi i të Drejtës së BE-së në Praktikë”, i cili përmban shpjegime për supozimet e bëra në lidhje me efektet ligjore të Direktivave. Gjithashtu, manuali përmban një hyrje të përgjithshme në konceptin e "thirrjes në Direktivë" duke u mbështetur në mekanizmat korrigjues siç janë pavlefshmëria e akteve procedurale, përjashtimi/shpërfillja e provave e kështu me radhë.

Kur bëjmë sugjerimin në formë të këshillës së “Fair Trials” në një rubrikë me kufizim të trefishtë dhe të hijezuar me të kaltër, ne mbështetemi në këtë qasje ndaj Direktivave në përgjithësi prandaj ju inkurajoheni që t’i referoheni Manualit “Përdorimi i të Drejtës së BE-së në praktikë” në këtë aspekt. Sidoqoftë, ka raste të caktuara kur duhet të bëhen vështrime specifike rreth mbështetjes në këtë Direktivë të veçantë, dhe këto janë të përfshira në këtë Udhëzues.

## c. Kini kujdes

Mendojmë se është e rëndësishme të theksohet se ky manual është hartuar në bazë të supozimeve të caktuara. Siç u përmend më sipër, jemi përpjekur të identifikojmë këto gjëra qartë në pjesën e tekstit, si për njohjen e faktit se mund të ketë pikëpamje të tjera, ashtu edhe për t’u siguruar që ju jeni të vetëdijshëm se këto janë konkluzione për të cilat ju duhet me dëshirë t’i përkrahni nëse dëshironi që të bazoheni në to para gjykatës.

Gjithashtu, manuali është hartuar me ndihmën e avokatëve nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Domosdoshmërishtë, ajo nuk mund të kujdeset për të gjitha variacionet individuale në procedurën penale në Shtetet e ndryshme Anëtare të BE-së (megjithëse kohë pas kohe përdor shembuj në nivel kombëtar për të vënë çështjet në kontekst). Përveç kësaj, nuk mund të marrë parasysh traditat ekzistuese profesionale dhe rregullat deontologjike të vendosura nga odat kombëtare ose rajonale të avokatëve. Kështu që duhet t’i përshtatni sugjerimet tona për të punuar brenda kontekstit tuaj lokal.

## d. Mbani kontakte

Me këto kualifikime, ne ju inkurajojmë që të ndiqni hapat e paraqitur në këtë Manual, provoni argumentet që ne propozojmë dhe na tregoni se si po ecën, duke na kontaktuar përmes informatave kontaktuese të dhëna në parathënie. Ne presim se do të ketë një proces të të mësuarit në vitin e parë ose në dy vitet e para pas afatit të zbatimit të Direktivave dhe do të dëshironim të dëgjonim nga ju për përvojat e juaja dhe të shkëmbejmë mësimet e nxjerra.

## B. PARA DIREKTIVËS: PERMBLEDHJA E PARIMEVE TË GJEDNJ

Direktiva mbulon fusha të caktuara të të drejtave të mbrojtjes të cilat - deri në një masë të caktuar - kanë qenë të mbuluara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Nëpërmjet prezantimit, ne do të tërheqim vëmendjen tuaj tek fillet kryesore të jurisprudencës sipas Neneve 5 dhe 6 të GJEDNJ-së. Rastet specifike brenda secilit grup shqyrtohen brenda tekstit të manualit, por ne ju inkurajojmë që të realizoni edhe hulumtimin tuaj.

**Neni 6, praktika gjyqësore i të qenit ‘i akuzuar’:** Rastet konfirmojnë se një personi gëzon garancitë e ofruara në Nenit 6 në pikën kur ata “akuzohen”, që interpretohet si momenti në të cilën ata bëhen të vetëdijshëm se dyshohen ose kur interesat e personit janë prekur ndjeshëm, që nënkupton kur ka dëshmi se ata kanë kryer një vepër penale.<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Rasti i [Bandelov v. Ukraine](#), Ap. nr. 23180/06 (Aktgjykimi i datës 31 Tetor 2013), paragrafi 56



**Neni 6, praktika gjyqësore mbi të drejtën për njoftim:** Parimet e vendosura në këto raste<sup>10</sup> tregojnë domosdoshmërinë e njoftimit të qartë të të drejtave (të ndara) për heshtje dhe për ndihmë juridike në momentin e arrestimit<sup>11</sup>, ashtu që t'i mundësojë të dyshuarit t'i kuptojë ato dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre. Ka sugjerime se njoftimi me gojë është i pamjaftueshëm në disa raste, dhe jurisprudenca tregon për nevojën që të merren parasysh karakteristikat specifike të individit (p.sh. të rinjtë).<sup>12</sup>

**Neni 5/6 praktika gjyqësore për njoftimin mbi akuzat:** Rastet sugjerojnë që i dyshuari duhet të jetë i vetëdijshëm për akuzat në momentin e marrjes në pyetje në fazën procedurës paraprake<sup>13</sup>. Një pjesë e veçantë e jurisprudencës ka të bëjë me rikualifikimin e veprave penale në faza të ndryshme të procedurave gjyqësore, p.sh. në apel; parimet kërkojnë që mbrojtja të njoftohet për ndryshimet në kualifikim ashtu që të përgatisë në mënyrë efektive mbrojtjen; ndryshimet në kualifikim, edhe nëse operohen nga gjykata pa e kërkuar argumentin, janë të pranueshme me kusht që rikualifikimi i tillë të mund të parashikohet<sup>14</sup>

**Neni 6, praktika gjyqësore për qasjen në lëndën e rastit:** Në fazën e gjykimit, praktika gjyqësore zakonisht ka të bëjë me mosdhënien e informacioneve mbi bazën e rendit publik dhe praktika gjyqësore parasheh balancimin e interesave në fjalë.<sup>15</sup> Në fazën e procedurës paraprake, ekzistojnë një numër rastesh në lidhje me paragjykimin e pretenduar shkaktuar mbrojtjes përmes kufizimeve praktike për qasje në lëndën e rastit para gjykimit, duke penguar përgatitjen e gjykimit.<sup>16</sup> Në fazën e marrjes në pyetje fillimisht nga ana e policisë, ekziston një pyetje e hapur nëse Neni 6 kërkon sigurimin e një sasive të caktuar të lëndës së rastit; një aktgjykim sugjeron që mundet<sup>17</sup> por, në përgjithësi, kjo fushë nuk është hulumtuar mjaftueshëm.

**Neni 5, praktika gjyqësore për qasjen në lëndën e rastit:** Rasti i së drejtës në lidhje me Nenin 5(4) të KEDNJ zbaton parimin e "barazisë së armëve" të nxjerrë nga Neni 6, kërkesat për gjykim të drejtë në vendimmarrjen për paraburgim në procedurën paraprake për shkak të natyrës serioze të vendimit në fjalë. Jo të gjitha dokumentet duhet të zbulohen, por duhet të ofrohen ato që janë të nevojshme për të ankimuar ligjshmërinë e paraburgimit.<sup>18</sup>

<sup>10</sup> [Zaichenkov.Russia](#), Ap.nr.39660/02(Aktgjykimi i datës 18Shkurt2010),paragrafi38; [Pishchalnikovv.Russia](#), Ap.nr. 7025/04(Aktgjykimi i datës 24Shtator2009),paragrafi71. [Stojkovicv.FranceandBelgium](#), Ap.nr.25303/08(Aktgjykimi i datës27Tetor2011)(vetëm frëngjisht),paragrafi54; [Panovitsv.Cyprus](#), Ap.nr.4268/04(Aktgjykimi i datës 11Dhjetor 2008), paragrafi 65

<sup>11</sup> Rasti i [Salduz v. Turkey](#), Ap. nr. 36391/02 (Aktgjykimi i datës 27 Nëntor 2008), paragrafi 50-55.

<sup>12</sup> [Panovits v. Cyprus](#), shënimi 10 i cituar më lartë, paragrafi 67, 73.

<sup>13</sup> Rasti i [Mattoccia v. Italy](#), Ap. nr. 23969/94 (Aktgjykimi i datës 25 Korrik 2000), paragrafi 63-64

<sup>14</sup> Rasti i [J.H. and others v. Austria](#), Ap. nr. 42780/98 (Aktgjykimi i datës 20 Prill 2006), paragrafi 36-38.

<sup>15</sup> Rasti i [Jasper v. The United Kingdom](#), Ap. nr. 27052/95 (Aktgjykimi i datës 16 Shkurt 2000), paragrafi 52

<sup>16</sup> <sup>16</sup>Rasti i [Iqlinv.Ukraine](#), Ap.nr.39908/05(Aktgjykimi i datës 12Janar2012),paragrafi60;Rasti i [Vyerentsov.Ukraine](#), Ap.nr.20372/11,(Aktgjykimi i datës f11Prill 2013),paragrafi73-76;Rasti i [Öcalanv.Turkey](#), Ap.nr.46221/99, (Aktgjykimi i datës 12 Maj 2005), paragrafi 142.

<sup>17</sup> Rasti i [Sapan v. Turkey](#), Ap. nr. 17252/09 (Aktgjykimi i datës 20 Shtator 2011), paragrafi 21

<sup>18</sup> Rasti i [Lamyv.Belgium](#), Ap.nr.10444/83, (Aktgjykimi i datës30Mars1989),paragrafi29;Rasti i [Schopsv.Germany](#), Ap.nr.25116/94(Aktgjykimi i datës 13Shkurt2001),paragrafi 44

## C. PËRMBLEDHJE E DIREKTIVËS

### 1. Pasqyrim i shkurtër


Dispozita	Çka mbulon	Aspektet e veçanta
Neni 1	Lënda	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përcakton rregullat në lidhje me të drejtën e informimit të të dyshuarve dhe personave të akuzuar rreth të drejtave të tyre në procedurën penale dhe akuzën kundër tyre.</li><li>• Zbatohet edhe për rastet e Urdhërarrestit evropian</li></ul>
Neni 2	Fushëveprimi	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zbatohet nga momenti kur personat "njoftohen nga autoritetet kompetente ... se ata dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një vepre penale e deri në përfundimin e procedurës".</li><li>• Në rastet kur kundërvajtje është sanksionuar administrativisht dhe vetëm ankesa është parashtruar para një gjykate, Direktiva zbatohet vetëm për procedurat pranë gjykatës.</li></ul>
Neni 3	E drejta për t'u informuar lidhur me të drejtat	<ul style="list-style-type: none"><li>• E drejta e të dyshuarve ose personave të akuzuar që t'u sigurohen menjëherë informacione lidhur me të drejtat procedurale, duke përfshirë:<ul style="list-style-type: none"><li>○ Qasjen në avokatë;</li><li>○ Të drejtën në këshilla ligjore falas dhe kushtet për marrjen e këshillave të tilla ligjore;</li><li>○ Informimin rreth akuzës;</li><li>○ Interpretimin dhe përkthimin; dhe</li><li>○ Heshtjen.</li></ul></li><li>• Informacioni duhet të jepet me gojë ose me shkrim, në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke marrë parasysh nevojat e të dyshuarve / personave.</li></ul>

Neni 4

Dokumenti i të drejtave mbi arrestimin

- I jep të drejtën të dyshuarve ose personave të akuzuar, të cilët janë arrestuar ose paraburgosur, në një Dokument të shkruar të të Drejtave. Ata duhet të jenë në gjendje të lexojnë dokumentin dhe ta mbajnë atë gjatë tërë kohës që janë paraburgosur.
- Dokumenti i të Drejtave gjithashtu përmban informacione për të drejtat e mëposhtme:
  - Qasja në materialet e rastit;
  - Informimi i autoriteteve konsullore dhe një personi;
  - Qasja në ndihmën urgjente mjekësore; dhe
  - Numri maksimal i orëve që ata mund të privohen nga liria para se të paraqiten para një autoriteti gjyqësor.

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informimi për sfidime ligjshmerisë së një arrestimi; marrjen e shqyrtimit të paraburgimit; ose parashtrimi i kërkesës për lirim të përkohshëm.</li> <li>• Hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.</li> <li>• I dyshuari ose i akuzuari e pranojnë dokumentin e shkruar në gjuhën që ata e kuptojnë.</li> <li>• Shembulli model është dhënë në Shtojcën 1.</li> </ul>
Neni 5	Dokumenti i të Drejtave në procedurat e Urdhrit Evropian të Arrestit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personave, të cilët janë arrestuar me qëllim të ekzekutimit të një Urdhri Evropian të Arrestit, iu sigurohet menjëherë nga një Dokument i të Drejtave për të mbrojtur drejtësinë e procedurave dhe ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes.</li> <li>• Shembulli model është dhënë në Shtojcën 2.</li> </ul>
Neni 6	E drejta në informim rreth akuzës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mundëson personave të dyshuar ose të akuzuar informimin mbi veprën penale që dyshohen ose akuzohen se kanë kryer.</li> <li>• Personat të cilët janë arrestuar ose paraburgosur duhet të informohen për arsyet e arrestimit ose paraburgimit të tyre.</li> <li>• Sigurohet që ofrohen informacione të hollësishme rreth akuzës, më së largu gjatë procedurave në gjykatë, përfshirë natyrën dhe klasifikimin juridik të veprës penale, si dhe natyrën e pjesëmarrjes së të akuzuarit.</li> <li>• I dyshuari ose i akuzuari duhet të informohet menjëherë për çdo ndryshim në informacionet e dhëna.</li> </ul>
Neni 7	E drejta e qasjes në materialet e rastit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dokumentet thelbësore për ankimimin efektivë të ligjshmerisë së arrestimit ose paraburgimit duhet t'u vihen në dispozicion personave të arrestuar ose avokatëve të tyre.</li> <li>• Atyre personave ose avokatëve të tyre duhet t'u ofrohet qasja të paktën në të gjitha provat materiale në posedim të autoriteteve kompetente, me qëllim të mbrojtjes së rregullshmerisë së procedurave.</li> <li>• Qasja në materiale duhet të jepet në kohën e duhur për të lejuar ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes dhe më së voni pas dorëzimit të akuzës në gjykatë.</li> <li>• Pa paragjykuar ndaj kërkesave që lidhen me dokumentet thelbësore për kundërshtimin e paraburgimit, qasja mund të refuzohet nëse kjo mund të çojë në një kërcënim serioz</li> </ul>



për jetën ose të drejtat themelore të një personi tjetër ose për të mbrojtur interesin publik.

---

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Refuzimi i qasjes në materiale të caktuara duhet të bëhet nga një autoritet gjyqësor ose të paktën i nënshtrohet një shqyrtimi gjyqësor.</li> <li>• Qasja do të jetë pa pagesë.</li> </ul>
Neni8	Verifikimi dhe mjetet juridike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kur informacionet u ofrohen të dyshuarve ose personave të akuzuar, duhet të vihet në dukje duke përdorur një procedurë regjistrimi.</li> <li>• E drejta për të sfiduar një dështim apo refuzim të mundshëm të autoriteteve kompetente për të dhënë informacione.</li> </ul>
Neni9	Trajnimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkesa për të siguruar trajnimin e 'gjyqtarëve, prokurorëve, policisë dhe stafit gjyqësor' për të drejtën e informimit.</li> </ul>
Neni10	Mos kthimi prapa	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Direktiva nuk kufizon masat mbrojtëse që lindin sipas ligjit ndërkombëtar ose kombëtar që ofron një nivel më të lartë mbrojtjeje.</li> </ul>

## 2. Qëllimi dhe objektivat

Ne do të përshkruajmë kërkesat thelbësore të Direktivës në Pjesët I-IV më poshtë. Sidoqoftë, në këtë pjesë hyrëse tashmë merret parasysh qëllimi i përgjithshëm i Direktivës, pasi kjo informon mënyrën se si duhet interpretuar të gjitha dispozitat thelbësore. Deklamimet- të cilat në vetvete nuk përcaktojnë detyrime, por që do të ndihmojnë në interpretimin e detyrimeve në Direktivë - së pari ofrojnë disa formulime të përgjithshme:

“(14)Kjo Direktivë(...) përcakton standardet e përbashkëta minimale që duhet të zbatohen në fushën e informimit për të drejtat dhe për akuzën që do t'u bëhet personave të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e një veprë penale (...) Kjo Direktivë bazohet në të drejtat e përcaktuara në Kartë dhe veçanërisht në Nenet 6, 47 dhe 48 të saj, duke u bazuar në Nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

...

“(33)Dispozitat e kësaj Direktive që korrespondojnë me të drejtat e garantuara nga KEDNJ ose Karta duhet të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me këto të drejta, siç interpretohen në praktikën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (...)”.

Këto rekomandime kapin tonin e përgjithshëm të manualit për ngritjen dhe konsolidimin e të drejtave që dalin nga KEDNJ, siç interpretohet nga GJEDNJ. Kjo është arsyeja pse, në këtë manual, ne ju ofrojmë parimet relevante të praktikës gjyqësore të GJEDNJ për të treguar se nga vjen Direktiva. Megjithatë, Direktiva është më e qartë, më e lehtë për t'u përdorur dhe mund të ofrojë mbrojtje më të fuqishme se GJEDNJ, prandaj ju inkurajojmë të mbështetni argumentet tuaja në Direktivë. Deklamimet e tjera pastaj ndërlidhen, madje në disa raste shtjellojnë të drejtat specifike në Direktivë të cilat janë të përfshira në këtë manual.

## D. PUNA PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E DIREKTIVËS

Para se të merrni në konsideratë situatat praktike për të cilat dëshironi të mbështeteni në Direktivë, është e këshillueshme që të bëni disa kërkime për t'u siguruar që jeni duke u bazuar në materialet e duhura juridike dhe materialet e të tjera me rastin e parashtrimit të pyetjeve sipas Direktivës.

### 1. Kontrolloni ligjin dhe praktikën kombëtare nga pikëpamja e Direktivës

Aspektet e procedurës penale, që lidhen me këtë Direktivë, mund të jenë të natyrës së dytë për ju. Megjithatë, ja vlen të bëni një hap prapa dhe të kontrolloni përsëri kornizën legjislative dhe praktike nga pikëpamja e Direktivës. Mund të jenë bërë ndryshime të reja në legjislacionin kombëtar dhe/ose në politikën e miratuar së fundmi për zbatimin e Direktivës, dhe do të jetë e dobishme nëse shikohen dispozitat përkatëse nga perspektiva e kërkesave të Direktivës, pasi kjo do t'ju ndihmojë të krijoni një pikëpamje fillestare se ku mund të lindin problemet e pajtueshmërisë.

Përdorni çdo sistem në dispozicion në sistemin tuaj kombëtar për identifikimin e dispozitave përkatëse. Nga perspektiva e BE-së, ekziston një mënyrë sistematike (por e papërsosur) për identifikimin e legjislacionit përkatës nëpërmjet bazës së të dhënave 'Eur-Lex', që ruan apo lidhet me tërë legjislacionin dhe jurisprudencën e BE-së, si dhe gjithnjë e më shumë me ligjet dhe jurisprudenca kombëtare. Këtu është një tregues i shkurtër se si të përdoret ky sistem për të gjetur legjislacionin që e ka marrë parasysh qeveria e Shtetit Anëtar për të siguruar pajtueshmërinë me Direktivën:

#### → Identifikoni legjislacionin përkatës kombëtarë

- Hyni në linkun <http://eur-lex.europa.eu> dhe zgjidhni gjuhën tuaj;
- Në seksionin "search by document reference" (ose ekuivalenti në gjuhën tuaj) shkruani "2012" në fushën "Viti" dhe "13" në fushën "Numri", dhe klikoni në kutinë "Direktiva" (kërkoni Direktivën 2012/13/BE);
- Kjo do të sjellë një link me titullin e plotë të Direktivës. Klikoni mbi të;
- Në ekran do të shihni tekstin e direktivës dhe një tabelë me linqe për disa versione gjuhësore. Mbi këtë gjenden disa skeda, një prej të cilave ka emrin 'Linked documents' (ose ekuivalenti në gjuhën tuaj). Klikoni në të;
- Më poshtë faqes do të shihni një opsion ku shkruan 'Shfaqini masat zbatuese kombëtare: MZK, link i ligjeve zbatuese të secilit shtet. Klikoni në të;
- Kaloni nëpër listën e rezultateve derisa të shihni emrin e Shtetit tuaj Anëtar të shfaqet si 'autor', me titullin e legjislacionit në fjalë. Mbani në mend se mund t'ju duhet të bëni hulumtime të mëtejshme përmes sistemeve lokale, pasi ky sistem nuk mund të kapë gjithçka që është relevante.

Ne ju sugjerojmë të shqyrtoni legjislacionin tuaj kombëtar, duke pasur parasysh të kuptuarit tuaj mbi mënyrën se si funksionon në praktikë, për të përcaktuar se si zbatohen Direktivat në terren në juridiksionin tuaj. Çështjet kyçe, që do të sugjeronim, janë si në vijim:

#### → Shqyrtoni ligjin dhe procedurën kombëtare nga pikëpamja e Direktivës

##### **Njoftimi i të drejtave**

- Si i njoftohen të drejtat personave të dyshuar apo të akuzuar?
- A përdoret i njëjti proces për personat e arrestuar dhe ata jo të arrestuar?

- Për personat e arrestuar, a marrin njoftimin me shkrim për të drejtat e tyre dhe kur? A është ky procesverbal i një njoftimi verbal apo dokument i veçantë? A ju jepet ky dokument para se marrjes në pyetje dhe a është i dyshuari në gjendje ta mbajë atë? A është hartimi lehtësisht i kuptueshëm? A janë të disponueshme përkthimet për personat jo-shtetas?

#### ***Njoftimi i akuzave***

- Çfarë informacione merren nga personat e dyshuar pas arrestimit? Çfarë forme merr ky njoftim?
- Çfarë detaji i dyshimit jepet në momentin e arrestimit lidhur me (i) aktet për të cilat personi dyshohet se ka kryer; dhe (ii) klasifikimi juridik i dhënë atyre akteve? Mendoni për atë që kërkohet me ligj, dhe atë që aktualisht ofrohet në praktikë.

#### ***Qasja në lëndën e rastit***

- A ofrohen materiale plotësuese me akuzën në momentin e marrjes në pyetje? Kush e merr këtë vendim? A kontrollohet kjo juridikisht?
- A sigurohen materialet gjatë fazës hetimore para vetë gjyqimit? Çfarë kufizimesh zbatohen? Kush e merr vendimin? A kontrollohet kjo juridikisht?
- A ekzistojnë dispozita specifike që rregullojnë çështjen e qasjes në dokumente në kontekstin e vendimeve të paraburgimit / arrestimit?

## **2. Bisedoni me kolegët/odat e avokatëve**

Është shumë e mundshme që Direktiva, e ndoshta edhe masat zbatuese kombëtare, nuk do të bëhen menjëherë të ditura për të gjitha palët e interesit. Mirëpo, nëse më shumë avokatë kanë njohuri për masat dhe kërkojnë të bazohen në to, policia dhe gjykatat do të vërejnë argumentimet e njëjta që vazhdojnë të përsëriten. Kjo do ta bëjë këtë çështje më të vështirë që të injorohet si dhe do të shtojë besueshmërinë e argumenteve të bazuara në Direktivë. Ne sugjerojmë:

#### **→Përhapni fjalën:**

- Pyesni odat lokale / kombëtare të avokatëve për të parë nëse kanë informata, burime apo iniciativa ekzistues që lidhen me këto çështje. Nëse jo, sugjeroni atë.
- Shpërndani këtë manual mes rrjeteve ligjore dhe përmes Odave të Avokatëve.

Diskutimi rreth Direktivave dhe mënyrës së përdorimit të tyre është i ri dhe është pjesë e rëndësishme e strategjisë për zbatim që është hartuar nga LEAP. Në këtë kontekst, anëtari i Bordit Këshillëdhënës të LEAP për Portugalinë, Vania Costa Ramos, ka shkruar për përdorimin e Direktivës në praktikën penale portugeze dhe ne ju inkurajojmë që të lexoni përkthimin në gjuhën angleze që kemi vënë në dispozicion.<sup>19</sup> Nëse keni shkruar diçka që mendoni se do të ndihmonte kolegët në Shtetet e tjera Anëtare, ju lutemi na kontaktoni.

<sup>19</sup> VaniaCostaRamos, 'Përdorimi i së Drejtës Evropiane në praktikën penale', përkthimi në gj. Angleze është siguruar nga Fair trials, që është në dispozicion në vegzën <http://www.fairtrials.org/publications/article-the-use-of-european-law-in-criminal-proceedings/>.



# I - NJOFTIMI I TË DREJTAVE TË DYSHUARVE

## A. ÇËSHTJA

---

Ju e dini shumë mirë rëndësinë e informimit të të dyshuarve për të drejtat e tyre në fillim të procedurave gjyqësore. Për shembull, nëse klienti e di se ai ka të drejtë të qëndrojë në heshtje dhe se kjo - në shumicën e vendeve - nuk mund të përdoret kundër tij, kjo do të parandalonte klientin nga dhënia e ndonjë deklarate që do ta inkriminojë atë. Po aq e rëndësishme, në mos më e rëndësishme, është fakti që nëse të dyshuarit informohen për të drejtën e tyre në këshillim ligjor dhe kuptojnë se nuk është obstruktive nëse thirren në atë të drejtë, ata kanë më shumë gjasa të gëzojnë të drejtat e tjera, veçanërisht të drejtën për heshtje dhe të drejtën e interpretimit nëse është e nevojshme.

Direktiva i përgjigjet problemit të njoftimit joefektiv të të drejtave. Komisioni në lidhje me këtë Direktivë deklaroi se në shumë nga 8 milion procedimeve penale në BE çdo vit, të dyshuarit informohen vetëm me gojë për të drejtat e tyre të mbrojtjes, në një gjuhë teknike dhe të pakuptueshme, ose nuk informohen fare.<sup>20</sup>

Kjo mangësi ka implikime të rënda për strategjinë e mbrojtjes, gjasën e dënimit dhe ankimimin kundër paraburgimit. Çdokush që është arrestuar dhe/ose që është marrë në pyetje nga policia, do të jetë në një situatë stresuese dhe veçanërisht të cenueshme. Mos informimi i një të dyshuari në mënyrë efektive për të drejtat e tij në një mënyrë që të sigurohet se ai i kupton ato, do të thotë se ai mund të mos jetë në dijeni për to ose të mos jetë i përgatitur për t'i ushtruar ato. Takimet e mbajtura nga Fair Trials në vitet e fundit kanë shpërfaqur një sërë problemesh:

- Njoftimet me shkrim i për të drejtat procedurale që ju jepen të dyshuarve shpesh hartohen në terminologji të ndërlikuar juridike (nganjëherë thjesht duke rishkruar dispozitat e kodit të procedurës penale) të cilat janë vështirë të kuptueshme për shumë nga të dyshuarit;
- E drejta në heshtje shpesh njoftohet në terma që e bëjnë ushtrimin e saj të papërshtatshëm. E drejta mund të shprehet si e drejtë për të “refuzuar përgjigjen në pyetje” dhe dokumenti (siç ishte rasti austriak nga nëntori i vitit 2014) mund të tërheqë vëmendjen ndaj pasojave të rënda të mundshme, si rritja e mundësisë së paraburgimit ose pamundësia për të sqaruar pafajësinë e dikujt;
- Të drejtat njoftohen vetëm kur personi është zyrtarisht nën dyshim/arrest / hetim; në disa raste, personat e marrë në pyetje si dëshmitarë në fakt dyshohen, por nuk informohen për të drejtat e tyre dhe mund të japin përgjigje që ndikojnë në rrjedhën e procedurës gjyqësore.
- Mos-njoftimi në mënyrë efektive për të drejtat nënkupton që të dyshuarit “heqin dorë” nga të drejtat e tyre për të qëndruar në heshtje dhe për avokat pa i kuptuar mjaftueshëm se çfarë janë ato të drejtat, duke çuar në dyshim nëse kjo heqje dore është bërë në mënyrë të vetëdijshme dhe të qartë.

---

<sup>20</sup> Evropa, 3 Dhjetor 2010, Dokumenti lidhur me Masën B: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-10-1652\\_en.htm?locale=en](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-10-1652_en.htm?locale=en)

## **B. BAZA E GJEDNJ-së**

---

Në jurisprudencën e saj mbi Nenin 6(1) dhe (3)(c), lidhur me të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për ndihmë juridike, GJEDNJ ka komentuar në disa raste dhënien e informacionit të dyshuarve për të drejtat e tyre. Kjo në përgjithësi ngritet në bazë të jurisprudencës së saj lidhur me 'heqjen dorë' nga këto të drejta, që praktika gjyqësore sugjeron se mund të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhet me dijeni:

'As dokumenti dhe as fryma e Nenit 6 nuk e pengon një person nga heqja dorë me vullnetin e tij të lirë, qoftë shprehimisht ose në mënyrë të heshtur, nga garancitë për një gjykim të drejtë. Megjithatë, në mënyrë që të jetë efektive për qëllimet e Konventës, heqja dorë nga e drejta duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe të përcillet me masat mbrojtëse minimale (...)Heqja dorë nga një e drejta, pasi të jetë thirrur në të, jo vetëm që duhet të jetë vullnetare, por edhe duhet të bëhet me dijeni dhe informatat mbi heqjen dorë nga një e drejtë. Përpara se një i akuzuar të thuhet se në mënyrë implicite, nëpërmjet veprimit të tij, ka hequr dorë nga një e drejtë e rëndësishme sipas Nenit 6, duhet të tregohet se ai ka mundur të parasheh në mënyrë të arsyeshme se cilat do të ishin pasojat e veprimit të tij (...).<sup>21</sup>

Kur të drejtat procedurale nuk i komunikohen në mënyrë efektive të dyshuarit, GJEDNJ konstaton se heqja dorë nuk është efektive pasi konsideron se vendimi për heqjen dorë nga e drejta nuk është marrë në baza të informimit të duhur. Rrjedhimisht, mbështetja në deklaratat e marra në atë kontekst atëherë nënkupton se është cenuar mbarëvajtja e procedurës si tërësi. Gjykata ka theksuar faktorë të ndryshëm, si objektivë ashtu edhe subjektivë, që ndërlidhen me njoftimin e të drejtave që ndikojnë në vlefshmërinë e heqjes dorë nga e drejta e qasjes në avokat dhe këshillim:

- Fakti që të drejtat janë njoftuar në një gjuhë tjetër nga ajo amtare e të dyshuarit, pa ndihmën e një përkthyesi.<sup>22</sup>
- Fakti se njoftimi është bërë vetëm me gojë në formë të një mase standarde (që mezi shërben për njohjen e të dyshuarit me përmbajtjen e të drejtave),<sup>23</sup>
- 'Situata stresuese' dhe 'radhitja e shpejtë e ngjarjeve' që çojnë në marrjen në pyetje të të dyshuarit,<sup>24</sup>
- Një 'konfuzion i caktuar' në mendjen e të dyshuarit në momentin e marrjes në pyetje,<sup>25</sup>
- Moshë e re e të dyshuarit,<sup>26</sup>
- Niveli arsimor i të dyshuarit,<sup>27</sup>
- Njohuria me takimet me policinë,<sup>28</sup> dhe
- Vartësia e të dyshuarit nga drogat.<sup>29</sup>

## C. DISPOZITAT RELEVANTE TË DIREKTIVËS

### 1. Fushëveprimi i obligimit për njoftim

Direktiva kërkon informata mbi të drejtën e njoftimit të personave të cilët dyshohen ose akuzohen në procedura penale. Megjithatë, pika që përzgjedh (siç bëjnë edhe Direktivat e tjera) për të përcaktuar fushëveprimin e aplikimit të saj është paksa problematike. Neni 2(1)

<sup>21</sup> Rasti i [Saman v. Turkey](#), Ap. nr. 35292/05 (Aktgjykimi i datës 5 Prill 2011).

<sup>22</sup> [Saman kundër Turqisë](#), i cituar në referencën e mësipërme 21, paragrafi 35.

<sup>23</sup> [Panovits kundër Qipros](#), i cituar në referencën e mësipërme 10, paragrafi 74.

<sup>24</sup> [Zaichenko v. Rusia](#), i cituar në referencën e mësipërme 10, paragrafi 55.

<sup>25</sup> [Stojkovic v. France and Belgium](#), i cituar në referencën e mësipërme 10, paragrafi 53.

<sup>26</sup> [Panovits kundër Qipros](#), i cituar në referencën e mësipërme 10, paragrafi 67.

<sup>27</sup> Rasti i [Kaciu and Kotorri v. Albania](#), Ap. nr. 33192/07 dhe 33194/07 (Aktgjykimi i datës 25 Qershor 2013), paragrafi 120

<sup>28</sup> [Pishchalnikov v. Rusia](#), i cituar në referencën e mësipërme 10, paragrafi 80.

<sup>29</sup> Rasti i [Plonka v. Poland](#), Ap. nr. 20310/02 (Aktgjykimi i datës 31 Mars 2009), paragrafi 38

parashikon:

'1.Kjo Direktivë zbatohet nga koha kur personat njoftohen nga autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar se dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një vepre penale.'

Kjo e ngritë çështjen se çfarë mbrojtjeje i ofron Direktiva një personi për të cilin autoritetet kanë arsye të besojnë se ka kryer një vepër penale, por që nuk është "vënë në dijeni" se ai është i dyshuar apo i akuzuar. Kjo është e mbuluar në pjesën për dëshmitarët, që është dhënë më poshtë në këtë manual (shih Pjesën IV).

## 2. Njoftimi i të drejtave

### a. Njoftimi mbi të drejtat e gjithë personave të dyshuar dhe të akuzuar

Të gjithë personat e dyshuar dhe akuzuar - qofshin të arrestuar apo të pa arrestuar - kanë të drejtë të njoftohen për të drejtat e tyre. Dispozitë relevante është Neni 3(1) i cili parasheh:

'1. Shtetet Anëtare u sigurojnë që të dyshuarve ose personave të akuzuar u sigurohen menjëherë të paktën informacione që kanë të bëjnë me të drejtat e mëposhtme procedurale, siç zbatohen sipas ligjit kombëtar, me qëllim që të lejohen që këto të drejta të ushtrohen në mënyrë efektive:

- (a) të drejtën për tu përfaqësuar nga avokati;
- (b) të drejtat për këshilla juridike falas dhe kushtet për marrjen e këshillave të tilla;
- (c) të drejtën që të informohet për akuzën, në përputhje me Nenin 6;
- (d) të drejtën për interpretim dhe përkthim;
- (e) të drejtën për të qëndruar i heshtur.

2.Shtetet Anëtare sigurohen që informacioni i paraparë në paragrafin 1 të jepet me gojë ose me shkrim, në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të të dyshuarve të cënueshëm ose personave të akuzuar të cënueshëm.'

Një detaj tjetër në lidhje me kohën është dhënë në referencën 19, e cila parasheh që:

'(19)Autoritetet kompetente duhet të informojnë menjëherë të dyshuarit ose personat e akuzuar, qoftë me gojë ose me shkrim, për ato të drejta që zbatohen sipas ligjit kombëtar, e të cilat janë thelbësore për të mbrojtur rregullshmërinë e procedurës gjyqësore, siç parashikohet në këtë Direktivë. Për të lejuar ushtrimin praktik dhe efektiv të këtyre të drejtave, informacionet duhet të sigurohen menjëherë gjatë rrjedhës së procedurës dhe së paku para intervistimit të parë zyrtar të të dyshuarit ose personit të akuzuar nga policia ose nga një autoritet tjetër kompetent.'

Tashmë do të vini re theksin në sigurimin se të drejtat janë komunikuar në mënyrë efektive, në mënyrë që të mundësohet ushtrimi i tyre: të drejtat duhet të njoftohen “menjëherë”, “me qëllim që të lejohen që këto të drejta të ushtrohen në mënyrë efektive”; gjuha duhet të jetë “e thjeshtë dhe e kuptueshme” duke marrë parasysh nevojat e veçanta të të dyshuarit. Dispozitat gjithashtu kërkojnë dhënien e informacioneve “më së paku para intervistimit të parë zyrtar”, një shprehje e cila paraqet vështirësi për po të njëjtën arsye të përmendur më lart në lidhje me Nenin 2 (1): marrja në pyetje mund të bëhet para njoftimit zyrtar për dyshimin.

### 3. Njoftimi i të drejtave- personat e arrestuar

Risi kryesore e Direktivës është krijimi i një detyrimi pozitiv ndaj Shteteve Anëtare që t`u sigurojnë personave të arrestuar një “dokument të të drejtave” që shpjegon të drejtat e tyre. Neni 4 parasheh që:

‘1.Shtetet Anëtare sigurohen që të dyshuarve ose personave të akuzuar, të cilët janë arrestuar ose paraburgosur, t’iu ofrohet menjëherë Dokumenti i të Drejtave me shkrim. Atyre u jepet mundësia që ta lexojnë Dokumentin e të Drejtave dhe t’iu lejohet që ta mbajnë atë në posedim gjatë gjithë kohës sa janë të privuar nga liria.

2.Përveç informacioneve të përcaktuara në Nenin 3, Dokumenti i të Drejtave nga paragrafi (1) i këtij Neni përmban informacione mbi të drejtat e mëposhtme, pasi ato zbatohen sipas ligjit kombëtar:

(a) e drejta e qasjes në materialet e rastit;

(b) e drejta për informimin e autoriteteve konsullore dhe një personi;

(c) e drejta e qasjes në ndihmë urgjente mjekësore;

(d) numri maksimal i orëve ose ditëve që të dyshuarit ose personat e akuzuar mund të privohen nga liria para se të paraqiten para një autoriteti gjyqësor.

3. Dokumenti i të Drejtave gjithashtu përmban informacione themelore për secilën mundësi, sipas ligjit kombëtar, për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit; shqyrtimin e paraburgimit; ose për parashtrimin e një kërkesë për lirim të përkohshëm.

4. Dokumenti i të Drejtave hartohet në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Një model tregues i Dokumentit të të Drejtave është paraqitur në Shtojcën I.’

Pak më shumë hollësi janë dhënë në Deklamimin 22:

‘Kur të dyshuarit ose personat e akuzuar arrestohen ose paraburgosen, informacionet lidhur me të drejtat procedurale të zbatueshme duhet të jepen me anë të një *Dokumenti të shkruar mbi të Drejtat, të hartuar në mënyrë lehtësisht të kuptueshme, në mënyrë që t’i ndihmojë ata persona që të kuptojnë të drejtat e tyre (...)*’(ky theksim është shtuar).

Prapë vëmë në dukje theksin në tekstin e Direktivës mbi rolin e Dokumentit për të Drejtat sa i përket lehtësimit të kuptuarit të të drejtave procedurale. Gjithashtu do të sugjerim që “mundësia për të lexuar Dokumentin e të Drejtave” ka pak kuptim nëse nuk lexohet me idenë e përfshirë në Deklamimin 19, domethënë se kjo duhet të bëhet para marrjes në pyetje. Këto janë ide që do t'i zhvillojmë më poshtë.

## **D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË**

---

### **1. Pika paraprake: Direktiva rregullon çështjen e njoftimit, por jo edhe të drejtat aktuale**

Direktiva nuk rregullon thelbin e së drejtës për të qëndruar në heshtje, të drejtës për përfaqësim nga avokati, etj., që i lihet ligjit kombëtar, sipas rastit, duke ju nënshtruar detyrimeve sipas Direktivave të tjera (p.sh. Direktiva 2010/64/BE për të drejtën e interpretimit dhe përkthimit, Direktiva 2013/48/BE për të drejtën e qasjes në avokat, etj.). Megjithatë, Direktiva vendos standarde që kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën këto të drejta njoftohen, pasi ato ekzistojnë në të drejtën kombëtare.

Siç kemi vërejtur, kërkesa për njoftim efektiv të të drejtave ngritët në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si rrjedhojë e domosdoshme e çdo heqje dorë nga të drejtat: personi duhet të informohet për të drejtën e tij, ashtu që të heq dorë nga to në mënyrë efektive dhe që deklaratat e tij/saj të përdoren kundër tyre. Prandaj, Direktiva ndikon që të drejtat të mos cenohen nga mungesa e dijenisë për të drejtat procedurale, veçanërisht përmes heqjes dorë të pa-informuar nga të dyshuarit e pa përfaqësuar, duke synuar që të garantohet e drejta për gjykim të drejtë, prezumimi i pafajësisë dhe e drejtat e mbrojtjes, që janë të mbrojtura nga Nenet 47 dhe 48 të Kartës.

#### **1. Marrja e veprimeve në momentin e njoftimit (nëse jeni aty)**

Sigurimi i respektimit të Direktivës nënkupton dy gjëra: (i) përpjekja që të sigurohet respektimi i saj në momentin e njoftimit dhe (ii) ushtrimi i mjeteve ligjore nëse nuk zbatohet në momentin e njoftimit. Nevoja e mundshme për të kërkuar ushtrimin e një mase ligjore më vonë do të thotë që ju duhet të jeni të kujdesshëm për të dokumentuar ekzistencën e shkeljes së Direktivës, ashtu që të mbështeteni në të para gjykatës.

##### **a. Gjatë asistimit të dyshuarit**

Është e qartë se vlera reale e Dokumentit të të Drejtave është në ofrimin e mbrojtjes për një klient të pa përfaqësuar kundër heqjes dorë nga e drejta e tij për tu përfaqësuar nga avokati apo qëndrimi në heshtje. A nuk e mohon fakti që ju jeni aty, në stacionin e policisë, çfarëdo çështje që ka të bëjë me njoftimin e të drejtave? Në fund të fundit, nëse ju jeni aty, kjo është për shkak se i dyshuari është këshilluar për të drejtën e tij për tu përfaqësuar nga avokati dhe ai është thirrur në këtë të drejtë.

Ne mendojmë se BE është munduar të krijojë një qasje tepër të sigurt, ku i dyshuari i arrestuar ka (i) një njoftim me shkrim për të drejtat e tij dhe (ii) mbrojtjen juridike, nëse ai/ajo e zgjedh këtë mundësi. Përderisa e para synon të lehtësojë të dytën, mbetet një e drejtë e pavarur, e cila nuk shprehet si e kushtëzuar.

Në të vërtetë, Dokumenti i të Drejtave nuk është i tepërt edhe nëse avokati është i pranishëm. Për shembull, një i dyshuar i paraburgosur mund të merret në pyetje përsëri pas largimit të avokatit dhe do të përfitonte nga fakti se ai posedon një Dokument të të Drejtave për t'i kujtuar atij këshillën e dhënë nga avokati i tij për të qëndruar në heshtje. Po ashtu, në pritje të zbatimit të Direktivës për qasje në avokat, rregullat mund të ndryshojnë sa i përket shkallës së ndërhyrjes që i lejohej avokatit gjatë marrjes në pyetje dhe mund të ndodhë që posedimi fizik i Dokument të të Drejtave e fortifikon të dyshuarin në ushtrimin e të drejtës për të qëndruar i heshtur, siç është këshilluar nga avokati i tij para se të merret në pyetje. Më dukshëm, është e qartë se marrja e Dokumentit të të Drejtave - në gjuhën e vet, e përkthyer në përputhje me Direktivën 2010/64/BE - do të jetë e dobishme për një të dyshuar të huaj ose të akuzuar, prandaj është e rëndësishme që avokati të këmbëngulë për këtë.

- Të dyshuarit të arrestuar që jeni duke i ndihmuar nuk i është dhënë Dokumenti i të Drejtave ose nuk iu kanë shpjeguar të drejtat e tij mjaftueshëm. Çfarë duhet të bëni?
- Refuzoni të vazhdoni me intervistim deri sa të sigurohet Dokumenti i të Drejtave dhe deri sa ti jepet mundësia të dyshuarit që ta lexojë atë.
  - Theksoni faktorët e rëndësishëm, si natyra stresuese e situatës, çfarëdo shenje të shqetësimit tek klienti, të cilat tregojnë pse duhet të pasur kujdes të veçantë për tu siguruar se i dyshuari i kupton të drejtat e tij. Mendoni për faktorët e vendosur në praktikat gjyqësore të GJEDNJ-së (fq. 14 më lart) p.sh. varësia nga droga, mosha e re, etj.
  - Kjo do t'ju ndihmojë më vonë, nëse do t'ju duhet të ushtroni një mjetë ligjor për mosrespektimin e Direktivës, nëse keni arsye për ta bërë këtë.

## **b. Gjatë asistimit të dëshmitarit i cili bëhet i dyshuar**

Megjithëse kjo mund të jetë pak a shumë e zakonshme, varësisht nga juridiksioni, mund të ndodhë që ju të jeni të pranishëm kur një person merret në pyetje si dëshmitar, kurse ata në realitet janë të dyshuar. Kjo kërkon veprim që të sigurohet jo vetëm që ata të këshillohen për të drejtat e tyre, por gjithashtu se atyre u është treguar se cilat janë pretendimet kundër tyre. Për këtë arsye, ne e shqyrtojmë rastin e veçantë të dëshmitarëve pasi të përfundojmë mbulimin e njoftimit për të drejtat dhe njoftimin e akuzave për të dyshuarit e zakonshëm (shih Pjesën II).

## **2. Ankimimi kundër mos-njoftimit me të drejtat**

Ka më shumë gjasa që do të përballeni me situatën (më vonë në procedurë) kur interesat e klientit tashmë janë paragjykuar me akte procedurale (në veçanti nga marrja në pyetje në polici) të ndërmarra pa i njoftuar të dyshuarit për të drejtat e tyre në përputhje me Direktivën. Kjo ka shumë të ngjarë të ndodhë në rastin kur i dyshuari heq dorë nga e drejta për ndihmë juridike, që do të thotë se nuk ka qenë askush aty për ta ndihmuar atë që të ushtrojë të drejtat e tij.

### **a. Rasti paradigmë**

Fillojmë duke e shqyrtuar situatën relativisht të thjeshtë në të cilën klienti nuk është njoftuar fare për të drejtat e tij dhe ka dhënë deklaratë inkriminuese në intervistimin fillestar. Të supozojmë se kjo pavëmendshmëri është dukshme edhe në të dhënat e marra nga policia. Kur (në një fazë të mëvonshme) ju të keni kompetencat për të vepruar në lidhje me këtë rast, mund të thoni se ka pasur një shkelje të qartë të Direktivës dhe të kërkonti ushtrimin e një mjeti ligjor (shpalljen e aktit të pavlefshëm, të kërkonti shpërfilljen e dëshmitave, etj.) pasi që ka pasur shkelje të të drejtave të mbrojtjes. Këtu mund të shihni një "lidhje" të qartë mes shkeljes së përcaktimeve të Direktivës dhe nevojës për ushtrimin e një mjeti ligjor për të siguruar efektin e dobishëm të Direktivës. Kjo gjithashtu do të shtrihej edhe në "frutat e pemës së helmuar", pra akte procedurale pasuese, të cilat janë bërë të mundura vetëm si rezultat i aktit që ka bërë shkeljen e Direktivës. Kjo është e dobishme të mbahet mend gjatë shqyrtimit të shembujve më realë.

### **b. Përcaktoni se si njoftimi ka qenë i paefektshëm**

Siç u përmend më lart, Direktiva nuk rregullon të drejtat përmbajtjesore (substanciale), në veçanti të drejtën për të qëndruar në heshtje ose për qasje në avokat. Megjithatë, GJEDNJ konsideron se njoftimin joefektiv mbi të drejtat, në vetvete mund të krijoj padrejtësi, pasi që si i tillë mund të vë në dyshim çfarëdo heqje dorë të mëvonshme nga të drejtat e po ashtu edhe vendimet e marra në lidhje me mbrojtjen. E njëjta qasje duhet të zbatohet me Direktivën: nëse bëhet cenimi i të drejtës si rezultat i mos-njoftimit efektivë, lind detyrimi për ushtrimin e masave ligjore me qëllim që të ruhet rregullshmëria e procedurave.

#### **i. Forma dhe gjuha**

Një situatë e zakonshme e përshkruar është ajo në të cilën i dyshuari këshillohet për të drejtat e tij, por në një mënyrë që ai nuk i kupton ato me të vërtetë, dhe rrjedhimisht nuk i ushtron ato. Kini parasysh kërkesat e Direktivës: informacionet duhet të ofrohen në një



“gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme”, duke marrë parasysh “nevojat e veçanta të të dyshuarve të cenueshëm ose personave të akuzuar të cenueshëm”. Gjithashtu, Direktiva vë theksin mbi dhënien e dokumentit si një pikë e veçantë, e pa ndikuar nga burokracia e sigurimit të dokumentacionit tjetër, siç është njoftimi me shkrim i të dyshuarit (siç paraqitet nga modeli indikativ në Shtojcën e Direktivës, i cili është një dokument i pavarur). Kërkesa që i dyshuari të ketë “mundësinë që të lexoj” dokumentin nënkupton se kërkesa nuk mund të përmbushet duke e regjistruar me shkrim njoftimin me gojë të të drejtave menjëherë para marrjes në pyetje. Ne sugjerojmë që të kërkonti faktorët objektivë (p.sh. hartimin e Dokumentit të të Drejtave) dhe faktorët subjektivë (si gjendja e mendore ose rrethanat).

Natyrisht, faktorët objektivë, ndërlidhen me mënyrën në të cilën komunikohet informacioni. Bazuar në bisedat me anëtarët e rrjetit LEAP ne do të rekomandonim si në vijim:

→ Si është komunikuar informacioni?

- A është siguruar Dokumenti?
- Kontrolloni Dokumentin e të Drejtave, që duhet të jetë në posedimin e klientit tuaj të paraburgosur dhe krahasoni atë me modelin indikativ në Direktivë;
- Krahasoni Dokumentin me modele të tjera dhe identifikoni mënyrat në të cilat mendoni se është i paqartë;
- Krahasoni Dokumentin me gjuhën e kodit të procedurës penale dhe vendosni nëse është duke e shpjeguar apo thjesht duke e përsëritur atë;
- A përdor Dokumenti terminologjinë juridike (“dëmton mbrojtjen tuaj”, “paragjykon interesat tuaja”) e cila për shumicën e të dyshuarve është e vështirë për tu kuptuar?
- A është ofruar Dokumenti i të Drejtave si pikë e veçantë me një status të veçantë, apo thjesht është bashkuar me njoftimin e dyshimit, pa i dhënë rëndësinë e duhur të drejtave që përmban?

Përveç pikave objektive, duhet të shqyrtoni edhe rrethanat specifike në të cilat i dyshuari e ka gjetur veten në momentin e është njoftimit, përfshirë çdo dobësi që rrjedh prej kësaj. Në kërkim të parametrave përkatës, pasi që Direktiva (dhe Karta) duhet të lexohen në pikëpamjen e KEDNJ-së, do të mund të ishte e dobishme që të merren në konsideratë disa nga faktorët që konsiderohen të rëndësishëm nga GJEDNJ kur përcaktohet nëse të dyshuarit kanë hequr dorë me vetëdije (shih praktikrat e mësipërme gjyqësore në fq. 15).

## ii. Koha e njoftimit

Gjithashtu, duhet të shqyrtoni kohën e njoftimit të të drejtave, duke pasur parasysh kërkesën e Direktivës që të dyshuarit duhet të kenë mundësinë që të lexojnë Dokumentin e të Drejtave (e cila për të qenë e dobishme do duhej të nënkuptonte para marrjes fillestare në pyetje nga ana e policisë).

→ Merrni udhëzime nga klienti:

- Kur u është komunikuar informacioni?
- A janë bërë komente nga policia lidhur me pasojat e ushtrimit të të drejtave të përmendura në Dokument ose në lidhje me rëndësinë e dokumentit?
- A është këshilluar i dyshuari me kohë për të drejtat procedurale në mënyrë që të shqyrtoj shfrytëzimin e tyre *para* se të merrej në pyetje?
- A i është dhënë mundësia të dyshuarit që të lexoj letrën?

### iii. Njoftimi i dekurajues (zhbindës)

Gjithashtu, duhet të shihni nëse ka shenja se njoftimi ka qenë dekurajues (p.sh. përmes gjuhës negative që sugjeron se ushtrimi i së drejtës për të qëndruar në heshtje është jo-bashkëpunues), ashtu që vendimet nuk mund të thuhet se janë marrë lirishëm

→ A ka pas 'njoftim të dekurajues

- Identifikoni mënyrën në të cilën njoftimi ka qenë dekurajues. Në rastin e Dokumentit të të Drejtave, kjo mund të bëhet përmes tekstit.
- Vlerësoni shkallën në të cilën kjo, e kombinuar me presionin e rrethanave, mund të thuhet në mënyrë objektive se krijon efektin dekurajues

### c. Dokumentoni shkeljen

Nëse nuk keni qenë i pranishëm në momentin e marrjes në pyetje, do përballen me sfidën: si t'i vërtetoni gjërat kryesore, p.sh si dhe kur janë komunikuar informatat, apo nëse ato janë kuptuar, etj.? Ne do të sugjeronim se ekzistojnë dy rrugë kryesore. Natyrisht, burimi kryesor i informacionit është vetë klienti. Ju duhet të flisni me klientin dhe të bëni pyetje të thjeshta për të përcaktuar rrethanat:

→ Flisni me klientët dhe kuptoni se çfarë ka ndodhur, duke u fokusuar në pyetjet tuaja mbi çështjet e ngritura më lartë (si dhe kur janë njoftuar ata për të drejtat e tyre, nëse iu është dhënë Dokumenti mbi të Drejtat, a janë kuptuar ato, etj.). Mos supozoni që vetëm pse Dokumenti mbi të Drejtat është në dosje, ai edhe i është komunikuar në mënyrë efektive. Pyesni nëse ata e kanë Dokumentin e të Drejtave në posedim të tyre dhe nëse jo, pse jo.

Megjithatë, gjykatat me gjasë janë të vetëdijshme për mundësinë që të gjithë të dyshuarit të pohojnë se nuk janë njoftuar siç duhet për të drejtat e tyre. Për tu siguruar që gjykatat të kenë qasje të drejtë në këtë aspekt, ju duhet të mbështeteni në Direktivën dhe ligjet e BE-së në përgjithësi. Shqyrtoni Nenin 8(1), në dispozitën e titulluar "verifikimi dhe mjetet juridike":

'1. Shtetet Anëtare sigurohen që kur t'iu jepen informacionet personave të dyshuar ose personave të akuzuar në pajtim me Nenin 3 deri 6 kjo të shënohet duke përdorur procedurën e regjistrimit të përcaktuar në ligjin e Shtetit Anëtar në fjalë.'

Në mënyrë të qartë Direktiva vë një barrë mbi Shtetet Anëtare që të dokumentojnë ofrimin e informatave në përputhje me Direktivën. Nëse të dhënat nuk përfshijnë detajet kryesore (p.sh. konfirmimin se i dyshuari i ka kuptuar të drejtat), ju mund ta përdorni këtë në favorin tuaj dhe të thoni që gjykata duhet të marrë parasysh versionin e klientit tuaj për ngjarjen. Në të vërtetë, çfarë ka tjetër?

Edhe nëse të dhënat zyrtare sugjerojnë se Dokumenti i të Drejtave është ofruar, ju duhet të inkurajoni gjykatën që të marrë në konsideratë edhe dëshminë e klientit tuaj dhe të mos e konsiderojë juridiksionin e saj si të kufizuar. Kjo shtrihet thellë brenda procedurave të hollësishtme për ngritjen e çështjes së shkeljeve procedurale në kuadër të një Shteti Anëtar, por parimet e BE-së vlejnë. Në veçanti, parimi i efektivitetit kërkon që:

'rregullat e detajuara procedurale që rregullojnë veprimet për ruajtjen e të drejtave të një individi sipas [të drejtës së BE-së] (...) nuk duhet të bëjnë praktikisht të pamundur ose tepër të vështirë ushtrimin e të drejtave të përcaktuara nga ligji i BE-së.<sup>30</sup>

Mendojmë që mbi këtë bazë mund të ndërtohet një argument i arsyeshëm. Në mënyrë që të mundësohet ushtrimi i një mase efektive ligjore, gjykata duhet të siguroj që rregullat procedurale të cilat zbatohen nuk e privojnë të dyshuarin nga mundësia që të thirret në të drejtat e përcaktuara sipas Direktivës. Gjykata duhet të jetë në gjendje të marrë parasysh pikëpamjet e personit për mënyrën se si dhe kur është njoftuar ai për të drejtat e tij.

#### d. Vërtetimi i “cenimit”

Duket e arsyeshme që të vërtetohet cenimi i të drejtës i shkaktuar nga shkelja e tillë: me fjalë të tjera, sa është ndikuar negativisht “rregullshmëria e procedurave gjyqësore” ose “ushtrimi i të drejtave të mbrojtjes” nga një shkelje e tillë Direktivës? Pa u përmbushur kjo, *apriori*, nuk ka arsye që të thirret në Direktivë.

##### → Vërtetimi i cenimit

- A ka hequr dorë klienti nga e drejta e tij për të qëndruar në heshtje/për tu këshilluar pa informim të plotë?
- A ka pranuar klienti fajësinë apo ka dhënë ndonjë deklaratë tjetër inkriminuese pa qenë në dijeni për të drejtat e tij?
- A ka bërë klienti deklarime të cilat, megjithëse nuk janë inkriminuese, nuk janë në përputhje me deklaratimet e bëra më vonë?
- A ka shpjer marrja në pyetje në veprime të mëtejshme hetimore të cilat nuk do të ishin të mundshme në mungesë të këtyre deklaratave?

#### e. Thirruri në Direktivë dhe rendisni argumentet tuaja

Siç u përmend më lart, Direktiva nuk rregullon të drejtat specifike, prandaj nëse ankesa juaj ka të bëjë për shembull me një kufizim substancial mbi të drejtën e qëndrimit në heshtje (p.sh. heshtja e të dyshuarit është shfrytëzuar kundër tij, siç është e mundur në disa juridiksione), atëherë ankesa juaj duhet të bëhet sipas ligjit kombëtar. Sidoqoftë, deri në masën që mund të thuhet se sjellja e mbrojtjes, dhe në veçanti heqja dorë nga ndonjë e drejtë që çon në cenim (sidomos nëpërmjet pranimit të fajësisë), lind për shkak të mosrespektimit të Direktivës, kjo është një çështje e së drejtës së BE dhe bëhet detyrë e gjykatës që të siguroj drejtësinë e procedurës gjyqësore.

→ Argumentoni: Direktiva synon të sigurojë që një i dyshuar njoftohet efektivisht për të drejtat e tij në mënyrë që të sigurohet që ai/ajo mund t'i ushtrojë ato dhe të mos i heqë dorë nga to mbi baza të keq informimit. Në veçanti, Nenet 3 dhe 4 së bashku kërkojnë që personi i arrestuar të pajiset me një Dokument të të Drejtave, duke e njoftuar atë në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mes të tjerash, për të drejtën në përfaqësim nga avokati dhe të drejtën për të qëndruar në heshtje, ashtu që t'i mundësojnë atij të ushtrojë të drejtat e mbrojtjes. Këto dispozita, që kanë për qëllim t'ia akordojnë të drejtat individëve, padyshim kanë efekt të drejtpërdrejtë vertikal.

→ Në këtë rast, kërkesa e Direktivës nuk është respektuar. Klientit nuk i është siguruar fare Dokumenti i të Drejtave/Dokumenti i të Drejtave i ofruar nuk plotësonte kriterin e gjuhës së thjeshtë dhe të kuptueshme/Dokumenti i të Drejtave nuk është siguruar para marrjes në pyetje/nuk ka pas kujdes mjaftueshëm për tu siguruar që klienti është këshilluar për të drejtat e tij, siç është përcaktuar në rrethana të veçanta. Kjo përcaktohet nga procesverbalet / provat tjera që gjykata duhet të marrë parasysh për të siguruar që klienti mund të thirret në të drejtat e tij sipas ligjit të BE-së.

<sup>30</sup> Shih, RastinC-432/05 *Unibet* [ECLI:EU:C:2007:163:43](https://eur-lex.europa.eu/eli/cj/2007/163/43), paragrafi 43. Parimi mbulon afatet për sjelljen e apeleve, vendimeve rreth qëndrimit, kostos dhe kërkesave të tarifave gjyqësore për ngritjen e padive, etj.

- Kjo shkelje e Direktivës ka shkaktuar që klienti të inkriminojë veten pa e kuptuar plotësisht të drejtën e tij për të qëndruar në heshtje / përndryshe ka cenuar mbrojtjen e klientit.
- Neni 8(2) i Direktivës përcakton që duhet të ekzistojë e drejta për të kundërshtuar mosdhënien e informacioneve në përputhje me Direktivën. Në përputhje me Nenet 47 dhe 48 të Kartës, kërkohet një mjet juridik efektiv dhe kjo duhet të kërkojë gjykatave që të ndërmarrë veprime të tilla që janë në dispozicion të saj sipas ligjit kombëtar me qëllim që të korrigohet shkelja e Direktivës, në veçanti duke e shpallur marrjen në pyetje/aktin procedural si të pavlefshëm dhe/ose duke shpërfillur çfarëdo prove që rrjedh nga ai akt. Për më shumë informacionet rreth së drejtës së ankimit, shihni Manualin për “Përdorimin e së Drejtës të BE-së”.

# PJESA II - NJOFTIMI I ARSYEVE PER ARRESIN /AKUZËN

## A. ÇËSHTJA

---

Kërkesa për njoftimin mbi akuzat është e lidhur ngushtë me çështjen e njoftimit të të drejtave. I dyshuari duhet të marrë vendime të rëndësishme për mënyrën se si të organizoj mbrojtjen e tij, përfshirë nëse do të kërkojë këshilla juridike, të qëndrojë në heshtje apo t'i përgjigjet pyetjeve. Vendimet e tilla mund të merren në mënyrë efektive vetëm nëse i dyshuari e di çështjen kundër tij. Dështimi për të specifikuar akuzat/pretendimet mund të çojë në vendime të pamatura.

Për shembull, avokatët mbrojtës raportojnë se në rastet e drogës, policia nuk mund të sqarojë nëse i dyshuari dyshohet për posedim apo trafikim të drogës. Mos dijeni se cili është krimi i supozuar e pengon në masë të madhe, apo madje edhe parandalon zhvillimin e një strategjie efektive të mbrojtjes - klienti juaj mund të dëshirojë të pranojë fajësinë për posedim të drogës, por mund të mos dëshirojë të njëjtën nëse ka mundësi që një veprim i tillë e lehtëson dëshmimin e një aktakuze tjetër pasuese për trafikim të narkotikëve. Dhe nëse nuk dihen faktet e krimit, është e vështirë të sigurohet një alibi ose të shqyrtohet përputhshmëria e akuzave, gjë që nuk është e dobishme për klientin ose policinë.

Njësoj, nëse akuzat ndryshohen gjatë hetimeve apo gjykimit, është shumë e rëndësishme që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të njoftohen menjëherë me qëllim që të përshtatin strategjinë. Për shembull, nëse klienti juaj është akuzuar për vjedhje me kanosje (grabitje) dhe ju mund të përgënjeshtrosh me sukses kanosjen, duhet ta dini nëse gjykata ende është duke e shqyrtuar mundësinë e dënimit për vjedhje, apo e konsideron tërë akuzën si të pabazuar.

## B. BAZA E KEDNJ-së

---

Këto çështje tashmë janë mbuluar mjaft mirë në praktikat gjyqësore të GJEDNJ-së, në bazë të neneve 5(2) dhe 6(3)(a) dhe (b), të cilat parashikojnë:

### **Neni 5**

*2. Çdokush që arrestohet duhet të menjëherë informohet, në një gjuhën që ai e kupton, për arsyet e arrestimit dhe çdo akuze kundër tij.*

### **Neni 6**

*3. Çdokush që akuzohet për një vepër penale ka këto të drejta minimale:*

*) të informohet menjëherë, në gjuhën që ai kupton dhe në hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;*

*) të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësira për përgatitjen e mbrojtjes së tij;*

Në bazë të këtyre dispozitave, GJEDNJ ka zhvilluar parime në lidhje me njoftimin e personave të "akuzuar" për të drejtat e tyre (e cila, në lidhje me Nenin 6, mund të zbatohet për të dyshuarit që ende nuk janë kategorizuar si të tillë sipas ligjit kombëtar, duke përfshirë ata që formalisht janë kualifikuar si dëshmitarë - shih Pjesën IV).

Në lidhje me Nenin 5(2) të KEDNJ-së, GJEDNJ ka zhvilluar një qasje të përgjithshme ku personit duhet t'i ofrohet një shpjegim më i qartë i asaj që pretendohet kundër tij, në një gjuhë të përshtatshme, ashtu që ai/ajo të kuptojnë bazën për paraburgimin e tyre:

- *Paragrafi 2 i Nenit 5 (neni 5-2) përmban një masë mbrojtëse elementare që çdo person i arrestuar duhet të dijë se pse është privuar nga liria. Kjo dispozitë është një pjesë përbërëse e skemës së mbrojtjes, të ofruar nga Neni 5 (...) [D]uke u mbështetur në paragrafin 2 (...) çdo personi të arrestuar duhet t'i tregohet baza ligjore dhe faktike për arrestimin e tij, në një gjuhë të thjeshtë dhe jo-teknike që ai mund ta kuptojë, ashtu që nëse e sheh të arsyeshme, ai/ajo të mund të kundërshtoj në gjykatë ligjshmërinë e ndalimit në përputhje me paragrafin 4.<sup>31</sup>*

Duke e aplikuar këtë qasje në rastet e veprave penale, GJEDNJ ka dalur me disa gjetje të rëndësishme, që tregojnë nevojën për deklarata faktike, dhënien e menjëhershëm të arsyeve dhe akomodimin me nevojat e të dyshuarit të caktuar:

- *Shkelja për shkak të dhënies së urdhrave me shkrim duke paraqitur vetëm dispozitat përkatëse ligjore, pa përmendur ndonjë rrethanë faktike;<sup>32</sup>*
- *Shkelja për shkak të vonesës në dhënien e arsyeve të plota, duke vënë në dukje se përshkrimi i dispozitave ligjore mund të mos ketë qenë i mjaftueshëm, duke pamundësuar të dyshuarin që të familjarizohet me dispozitat ligjore;<sup>33</sup>*
- *Shkelja për shkak të marrjes në pyetje të një të dyshuari të arrestuar i cili ka qenë i shurdhër, memec (pa zë), analfabet dhe që ka pas aftësi të kufizuara mentale, duke përdorur një përkthyes zyrtar në gjuhën e shenjave kur i dyshuari nuk e ka përdorur atë formë të gjuhës së shenjave, pa ndihmën e nënës së të dyshuarit<sup>34</sup>*

Në lidhje me Nenin 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ ka zhvilluar një deklaratë standarde parimesh, duke specifikuar të drejtën për tu informuar, për të mundësuar mbrojtjen në të gjitha fazat e procesit:

- *Dispozitat e paragrafit 3 (a) të Nenit 6 tregojnë nevojën për t'i kushtuar vëmendje të veçantë njoftimit të "akuzës" së të pandehurit. Detajet e shkeljes luajnë një rol vendimtar në procesin penal, pasi që nga momenti i shërbimit të tyre, i dyshuari zyrtarisht vihet në dijeni me shkrim mbi bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij (...). Neni 6§3 (a) i Konventës i mundëson të pandehurit të drejtën për t'u informuar, jo vetëm për "shkakun" e akuzës, domethënë veprat për të cilat pretendohet se ka kryer dhe mbi të cilat bazohet akuza, por gjithashtu edhe karakterizimi ligjor i dhënë atyre akteve. Ky informacion duhet të detajohet.<sup>35</sup>*

GJEDNJ i ka zbatuar këto parime në situata të ndryshme, që kanë të bëjnë me faza të

<sup>31</sup> [Fox and others v. United Kingdom](#) Ap. nr. 12244/86 (Aktgjykimi i datës 30 Gusht 1990), paragrafi 40.

<sup>32</sup> [Petkov and Profirov v. Bulgaria](#) Ap. nr. 50027/08 (Aktgjykimi i datës 24 Qershor 2014), paragrafi 61.

<sup>33</sup> [Kortesis v. Greece](#) Ap. nr. 60593/10 (Aktgjykimi i datës 12 Qershor 2012), paragrafi 61

<sup>34</sup> [Z.H. v. Hungary](#) Ap. nr. 28973/11 (Aktgjykimi i datës 8 Nëntor 2012), paragrafi 42-43.

<sup>35</sup> Rasti [Kamasinski v. Austria](#), Ap. nr. 9783/82 (Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1989), paragrafi 79; Rasti [Pélissier and Sassi v. France](#), Ap. nr. 25444/94 (Aktgjykimi i 25 mars 1999), paragrafët 51-52, [Mattocia v. Italy](#), cituar në shënimin 13, paragrafi 58



ndryshme të procedurave, gjithmonë duke pyetur nëse dështimi i supozuar për njoftim mbi akuzën ka cenuar mbarëvajtjen e gjithë procedurës. Me poshtë janë dhënë disa shembuj të kohëve të fundit:

#### **Me rastin e arrestimit fillestar**

- *Asnjë shkelje, pasi që urdhër-arresti që ka çuar në arrestim, ka përcaktuar qartë akuzat penale të ngritura kundër aplikantit*<sup>36</sup>
- *Shkelja për shkak të marrjes në pyetje në një skaj të rrugës, ku personi i cili ka qenë nën dyshimin nuk është njoftuar për akuzën kundër tij,*<sup>37</sup> dhe
- *Asnjë shkelje, pasi që aplikantit i ishte dhënë një kopje e një raporti të inteligjencës që i jepte në hollësi veprimet që ajo akuzohej se kishte kryer.*<sup>38</sup>

#### **Në gjykim**

- *Shkelja që rrjedh nga dështimi i prokurorit që të paraqitet në gjykim dhe të specifikojë akuzat para dënimit të aplikantit.*<sup>39</sup>

Gjithashtu, ekziston një grup tjetër i parimeve lidhur me ri-klasifikimin e veprave penale në faza të ndryshme të procedurave. Këto ri-klasifikime janë të lejueshme, me kusht që të dyshuarit të kenë mundësinë që të përgatisin mbrojtjen:

- *Në qoftë se gjykatat që kanë bërë dëgjimin meritorë të çështjes kanë (...) mundësinë e ri-klasifikimit të fakteve të cilat janë të pranuar në mënyrë valide, ato duhet të sigurohen që personat e akuzuar kanë pasur mundësi të ushtrjnë të drejtat e tyre të mbrojtjes në mënyrë konkrete dhe efektive. Kjo nënkupton që ata duhet të informohen në kohën e duhur jo vetëm për shkakun e akuzës, përkatësisht fakteve materiale që paraqiten kundër tyre dhe mbi të cilat bazohet akuza, por gjithashtu, në mënyrë të hollësishme, edhe për klasifikimi ligjor dhënë atyre fakteve [përkthimi ynë].*<sup>40</sup>

GJEDNJ pastaj ka bërë disa gjetje duke zbatuar këto parime:

- *Shkelja për shkak të një gjykate apeli, që bënë rishqyrtimin e rastit të personave të dënuar për falimentim penal, duke i dënuar ata në mënyrë të paparashikueshme për ndihmën dhe inkurajimin e asaj vepre pa u dhënë atyre mundësinë për tu mbrojtur.*<sup>41</sup>
- *Shkelja që rrjedh nga vendimi i Gjykatës së Kasacionit për të ri-klasifikuar veprën penale si më serioze, pa paralajmërim ose ftesë për debat mbi ri-klasifikimin, në rrethanat kur aplikanti mund të ketë pasur argumente, nëse kjo do të ishte e parashikueshme.*<sup>42</sup>

<sup>36</sup> Rasti *Haxhia v. Albania*, Ap. nr. 29861/03 (Aktgjykimi i datës 8 Tetor 2013), paragrafi 131.

<sup>37</sup> *Zaichenko v. Russia*, referenca 10 e cituar më sipër, paragrafi 41-43

<sup>38</sup> Rasti i *Niculescu v. Romania*, Ap. nr. 25333/03 (Aktgjykimi i datës 25 Qershor 2013), paragrafi 119

<sup>39</sup> Rasti i *Malofeyeva v. Russia*, Ap. no. 36673/04 (Aktgjykimi i datës 30 Maj 2013), paragrafët 113-120.

<sup>40</sup> Case of *Drassich v. Italy*, Aplikacioni nr. 25575/04, (Aktgjykimi i datës 11 Dhjetor 2007), paragrafi 34 (vetëm në frëngjisht).

<sup>41</sup> *Pélissier and Sassi v. France*, referenca 35 e cituar më sipër, paragrafët 56-62.

<sup>42</sup> *Drassich v. Italy*, referenca 40 e cituar më sipër, paragrafët 36, 41-43.

Siç do të shihni nga më sipër, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së vë theksin në sigurimin që personi të këshillohet për akuzën kundër tij, me qëllim që t'i mundësohet atij të mbrojnë veten. Kjo tani është e mbrojtur me kërkesa të qarta në Direktivë.

### C. DISPOZITAT E RËNDËSISHME TË DIREKTIVËS

Direktiva e mbron të drejtën për njoftimin e akuzave nëpërmjet nenit 6. Në trajnimet mbi këtë Direktivë, "FreeTrials" ka arritur në përfundimin se paragjykimet e pjesëmarrësve lidhur me atë se çfarë nënkuptojnë këto dispozita ndryshojnë varësisht nga sistemi kombëtar në të cilin punojnë. Neni thotë:

'1. Shtetet anëtare sigurojnë që të dyshuarve ose të akuzuarve u sigurohen informata lidhur me veprën penale për të cilën dyshohen ose akuzohen se kanë kryer. Kjo informatë duhet të sigurohet menjëherë dhe në hollësitë që janë të nevojshme për të mbrojtur rregullshmërinë e procedurave dhe ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes.

2. Shtetet anëtare sigurojnë që të dyshuarit ose të akuzuarit të cilët janë arrestuar ose paraburgosur informohen lidhur me arsyet për arrestimin ose paraburgimin e tyre, duke përfshirë veprën penale për të cilën dyshohen ose akuzohen se kanë kryer.

3. Shtetet anëtare sigurojnë që më së voni deri në dorëzimin e bazueshmërisë së akuzës në gjykatë, ofrohen informata të hollësishme për akuzën, përfshirë natyrën dhe klasifikimin ligjor të veprës penale, si dhe natyrën e pjesëmarrjes së të akuzuarit.

4. Shtetet anëtare sigurojnë që të dyshuarit ose të akuzuarit informohen menjëherë për çdo ndryshim në informatat e ofruara në përputhje me këtë nen, kur një gjë e tillë është e nevojshme për të mbrojtur rregullshmërinë e procedurës.'

Hollësi të mëtejshme ofrohen nga recitimet 27 dhe 28, të cilat parashikojnë:

'(27) Personave të akuzuar për kryerjen e një veprë penale duhet t'u jepen të gjitha informatat mbi akuzën, të cilat janë të nevojshme për t'u mundësuar atyre që përgatisin mbrojtjen e tyre dhe të ruajnë rregullshmërinë e procedurës.

(28) Të dyshuarve ose të akuzuarve duhet t'u sigurohen menjëherë informatat lidhur me veprën penale për të cilën dyshohen ose akuzohen se kanë kryer, dhe më së voni para intervistës së tyre të parë zyrtare nga policia ose ndonjë autoritet tjetër kompetent dhe pa cenuar rrjedhën e hetimeve. Një përshkrim të fakteve, duke përfshirë, në rastet kur janë të ditura, koha dhe vendi, që kanë të bëjnë me veprën penale që personat dyshohen ose akuzohen se kanë kryer. Po ashtu, klasifikimi i mundshëm ligjor i veprës së pretenduar duhet të ofrohet në hollësi të mjaftueshme, duke marrë parasysh fazën e procedurës penale kur ofrohet një përshkrim i tillë, për të mbrojtur drejtësinë e procedurës dhe për të mundësuar ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes.'

Këto dispozita të nenit 6 janë disi konfuze dhe kanë nevojë për sqarime nga ana e GJDBE-së, duke e bërë të vështirë komentimin e tyre pa u mbështetur në një interpretim potencialisht të kontestueshëm. Disa pikëpamje për kuptimin e tyre, të cilat janë ndarë me ne gjatë trajnimeve individuale, janë paraqitur në vijim.



- Neni 6(1) është detyrim i përgjithshëm, i cili pasqyron nenin 6(3)(a) të KEDNJ. Prandaj, ky nen zbatohet përgjatë gjithë procedurës dhe siguron të drejtën e informimit për të gjithë personat në kuadër të fushëveprimit të direktivës, të dyshuar ose të akuzuar, të arrestuar apo jo.
- Neni 6(2) pasqyron detyrimet në nenin 5(2) të KEDNJ-së (i kombinuar me nenin 5(1)(c) të KEDNJ-së) dhe siguron mbrojtje për personat e arrestuar në mënyrë që ata të informohen me bazën për arrestimin e tyre. Ekziston një lidhje e mundshme me nenin 7(1) të direktivës (shih më vonë).
- Neni 6(3) në thelb i referohet aktit të aktakuzës, i cili kërkon klasifikim të qartë ligjor të veprës dhe natyrës së pjesëmarrjes së të akuzuarit. Kjo duket se përputhet me fokusin në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së mbi aktakuzën/detajet e veprës<sup>43</sup>, që i mundëson të akuzuarit të përgatitet për gjykimin e meritave. Megjithatë, nga interpretimi a contrario lind një problem: nëse klasifikimi ligjor kërkohet patjetër vetëm për aktakuzën, atëherë kjo nuk mund të kërkohet për njoftimin e hershëm të personave të arrestuar. Megjithatë, kjo pyetje përgjigjet nga kërkesa në nenin 6(2) për të specifikuar veprën ‘penale’ që personi dyshohet ose akuzohet se ka kryer: nëse është vepër penale, është e tillë pasi që një dispozitë e ligjit e kriminalizon atë dhe klasifikimi si i tillë supozohet. Në të vërtetë, Deklamimi 28 i referohet “klasifikimit të mundshëm ligjor” që ofrohet përpara intervistës së parë zyrtare. Neni 6(3) thjesht kërkon që pretendimi të specifikohet dhe të klasifikohet plotësisht në aktakuzë, siç përputhet me atë fazë të procedurës, pasi kjo është një pikë vendimtare për përgatitjen e mbrojtjes (siç njihet nga GJEDNJ).
- Neni 6(4) pasqyron kërkesën në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për riklasifikimet<sup>44</sup> e veprës që duhet të njoftohen me qëllim që të dyshuarit ose të akuzuarit t’i ofrohet mundësia që të paraqes mbrojtjen; sugjerimi se kjo duhet të bëhet vetëm “aty ku është e nevojshme” mund të ketë për qëllim ta pasqyrojë lejimin e ofruar nga GJEDNJ për riklasifikimet të cilat mund të ishin parashikuar dhe nuk kishin “nevojë” për njoftim paraprak.

## D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË

---

### 1. Identifikoni mangësinë në njoftimin e akuzave

#### a. Dështimi për klasifikim të veprës

Shqyrtoni situatën ku personi arrestohet por vepra nuk specifikohet. Mund të ketë të ngjarë që policia është duke shqyrtuar disa akuza të mundshme (p.sh. faktet e supozuara mund të konsiderohen si vjedhje ose grabitje me kanosje, apo posedim i thjeshtë i drogës ose posedim me qëllim të shitjes). Mund të jetë praktikë – ndonëse nuk sugjerojmë se kjo është praktikë e mirë – që policia të vendos për një kualifikim vetëm pas hetimeve të mëtejshme, por megjithatë të marrë në pyetje të dyshuarin në ndërkohë (p.sh., lidhur me shembujt e mësipërm, konsultimi me pamjet nga kamerat vëzhguese, ose vlerësimi i sasisë së substancës aktive në drogat e sekustruara).

#### b. Nënklasifikimi në pikën e marrjes në pyetje

<sup>43</sup> Rasti i *Juha Nuutinen v. Finland*, Nr. i ap. 45830/99 (Aktgjykimi i 24 prillit 2007), paragrafët 30-32.

<sup>44</sup> *Pélissier and Sassi v France*, përmendur më lart shënimi 35, *Drassich v. Italy*, përmendur më lart shënimi 40

Një rast që aktualisht është në pritje në GJEDNJ, *rasti Čierny kundër Sllovakisë*<sup>45</sup>, ka të bëjë me një person të arrestuar për veprën e organizimit të të trafikimit, që bartë në vete dënimin katër deri në dhjetë vjet, duke bërë rrëfime, shprehur keqardhje etj. Më vonë, vepra u riklasifikua si formë e rënduar e së njëjtës vepër, duke ngarkuar një dënim prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe duke kërkuar përfaqësim të detyrueshëm. Në këtë fazë nuk ka vendim të GJEDNJ-së, por kjo tregon qartë çështjen që ngrihet nga nën-klasifikimi i një vepre në pikën e marrjes në pyetje. Kjo mund të përfshijë moszbatimin e mbrojtjes procedurale të disponueshme sipas ligjit kombëtar për vepra më të rënda dhe/ose të nxisë bashkëpunimin e të dyshuarit në pritje të një akuze më të ulët, etj. Fair Trials ka ndërhyrë në këtë rast për ta theksuar rëndësinë e njoftimit efektiv të të drejtave procedurale dhe akuzës për të siguruar vendimmarrje të arsyeshme nga i akuzuari. Ju inkurajojmë të shihni nenin 6(1) pasi i njëjti i mban autoritetet përgjegjëse për ofrimin e informatave të plota dhe shmangien e abuzimit të këtyre mundësive.

### **c. Mos-specifikimi i mjaftueshëm i akuzave faktike**

Praktikuesit gjithashtu raportojnë se në disa raste ofrohen pak informata faktike përmes informatave ligjore bazë të akuzës (p.sh. mashtrimi i kryer kundër një personi në një kohë të caktuar, pa detaje për veprën e supozuar), ndoshta për të mos i zbuluar hollësitë e hetimeve të vazhdueshme. Një gjë e tillë i vështirëson të dyshuarit që të bashkëpunojë dhe të ofrojë dëshmi shfajësuese, të cilat mund të jenë të dobishme për policinë. Përveç kësaj, po ashtu vështirëson ofrimin e përgjigjes ndaj kërkesës për paraburgim. Praktikuesit në Spanjë, në veçanti janë ankuar lidhur me mos-ofrimin e më shumë se akuzave bazë, gjë që bën të pamundur zhvillimin e një diskutimi serioz lidhur me bazueshmërinë e rastit në fazën e paraburgimit. Gjykata e procedurës paraprake, në aspektin ligjor, ka kompetenca lëndore vetëm për shqyrtimin e bazës për paraburgim dhe jo bazueshmërinë e rastit, kështu që ekziston një vakum sa i përket shqyrtimit gjyqësor të bazueshmërisë së çështjes deri në fazat e mëvonshme.

## **2. Kërkoni informata në pikën e marrjes në pyetje dhe krijoni një dosje**

Ju inkurajojmë t'i referoheni direktivës në pikën e marrjes në pyetje. Referohuni në punën tuaj përgatitore për të parë nëse legjislacioni kombëtar që rregullon ofrimin e informatave për të dyshuarit është ndryshuar me qëllim të zbatimit të direktivës. Ky ka qenë rasti në Francë, për shembull, ku është parashtruar një kërkesë shtesë për klasifikimin ligjor të veprës në pikën e marrjes në pyetje. Dorëzoni rastin tuaj në institucionin përkatës paragyqësor (në shumicën e rasteve, policia):

<sup>45</sup> Rasti i [Čierny v. Slovakia](#), Nr. i ap. 29384/12 (në pritje).

- Kërkoni mbi bazën e direktivës, që i dyshuari të informohet në hollësi për krimin e supozuar, si në lidhje me klasifikimin e tij ligjor ashtu dhe me faktet e tij.
- Në lidhje me faktet, shpjegoni se si mos-ofrimi i hollësive (a) privon të dyshuarin nga mundësia për të komentuar në mënyrë të dobishme mbi ligjshmërinë e arrestimit ose për të ofruar dëshmi shfajësuese dhe (b) detyron të dyshuarin të marrë vendimin nëse do ta ushtrojë të drejtën e tij për të heshtur mbi një bazë të keq-informuar.
- Pyesni për veprën specifike penale që policia/prokuroria synon të ngarkojë, si dhe për çdo alternativë tjetër që ata parashikojnë. Bëni të qartë se këshillat që ju i ofroni klientit bazohen në të kuptuarit se me çfarë vepre do të ngarkohet klienti juaj.
- Shqyrtoni me kujdes nëse deklarata e dhënë në kontekstin e një vepre më pak serioze mund të inkriminojë më vonë klientin tuaj për një vepër më serioze. Nëse jeni në dyshim, këshilloni për heshtje derisa të dihet përmbajtja e saktë e akuzës. Vlerësoni këtë rrezik me kujdes ndaj rrezikut të paraburgimit të klientit tuaj.
- Kërkoni qasje në provat që janë në dispozicion në këtë fazë, në përputhje me nenin 7(1) siç ne e interpretojmë atë (shih Pjesën III). Nëse ju lejohet qasja, do t'ju ndihmojë të vlerësoni forcën e rastit në atë pikë dhe potencialin për akuzën më serioze që do të bëhet më pas. Nëse ju mohohet qasja, kjo do të forcojë rastin tuaj kur të mbështeteni më vonë në direktivë.
- Sigurohuni që kërkesat tuaja, duke përfshirë referencat tuaja ndaj direktivës, regjistrohen në protokollet e policisë/procesverbalet e procedurave. Kërkoni që çdo refuzim për të ofruar informata të tilla të regjistrohet, së bashku me arsyet e dhëna.

### 3. Kundërshtimi i shkeljes

#### a. Inkurajimi i veprimeve në instancën e paraburgimit

Rezultat i mundshëm i menjëhershëm i mos-specifikimit të hollësive në akuza, në veçanti është që ju do të privoheni nga mundësia për të zhvilluar diskutim serioz lidhur me forcën e rastit para një instance të paraburgimit. "Fair Trials" beson se është e qartë nga teksti i direktivës që ajo ka për qëllim t'i ofrojë një personi të arrestuar mundësinë për shqyrtim gjyqësor efektiv të paraburgimit (neni 6(1) siguron arsyet e arrestimit në hollësi dhe neni 7(1) siguron qasje në dokumentet e nevojshme për kundërshtimin e ligjshmërisë së paraburgimit). Prandaj, ju duhet ta inkurajoni gjykatën e paraburgimit që të mbrojë të drejtat e klientëve tuaj sipas nenit 6 të Kartës (e drejta për liri) duke siguruar që ofrohen informata të mjaftueshme.

- Kërkoni që gjykata e paraburgimit ta detyrojë prokurorinë të ofrojë më shumë informata nëse deri më tani janë dhënë hollësi të pamjaftueshme.
- Argumentoni: direktiva në mënyrë specifike kërkon të sigurojë respektimin e të drejtës së lirisë të mbrojtur nga neni 6 i Kartës, duke e vendosur të dyshuarin në posedim të informatave dhe materialeve të mjaftueshme për ta kundërshtuar arrestimin/ndalimin e tij. Domosdoshmërishtë kjo bie nën përgjegjësinë e paraburgimit që të siguroj respektimin e këtyre të drejtave duke detyruar autoritetin hetimor/prokurorial të ofrojë më shumë hollësi ose, në mungesë, të lirojë të dyshuarin.

#### b. Thirruni në Direktivë dhe kërkoni ushtrimin e mjetit ligjor për njoftimin joadekuat

Të supozojmë se tani jeni para forumit për të kundërshtuar shkeljet e procedurës paraprake (p.sh. argumentet e fazës së gjykimit në lidhje me vlefshmërinë e akteve procedurale). Mund të ballafaqoheni me një shkelje që tani është më serioze se ajo që është ngarkuar fillimisht. Deklaratat e mëhershme të bëra nga i dyshuari janë në procesverbal dhe këto mund të jenë të rrëzueshme sipas jush meqenëse ato u morën në thelb pa njoftim të plotë për seriozitetin e akuzës dhe ndoshta si rezultat i një taktike të qëllimshme të instancës paragjyqësore që të nxisin rrëfimin. Ne sugjerojmë:

- Argument: neni 6(1) kërkon ofrimin e informatave "në hollësi të atilla që konsiderohen të nevojshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurave dhe për të siguruar ushtrim efektiv të të drejtave të mbrojtjes" dhe kërkon ofrimin e informatave më gjithëpërfshirëse në dispozicion në kohën e marrjes në pyetje.
- "Ushtrimi efektiv i të drejtave të mbrojtjes në gjykim mund të cenohet nga mos-ofrimi i informatave më të hollësishme në një fazë më të hershme gjatë procedurës, p.sh. duke shmangur mbrojtjet procedurale në dispozicion për shkelje më të rënda, duke nxitur bashkëpunimin në bazë të një ideje të rrejshme lidhur me seriozitetin e shkeljes, etj. Gjithashtu mund të parandalojë mbrojtjen nga kryerja ose propozimi i veprimeve hetimore për të marrë dëshmi shfajësuese.

- Përderisa neni 6(3) kërkon ofrimin e informatave të hollësishme mbi akuzën si dhe natyrën dhe klasifikimin ligjor të shkeljes “më së voni” pas parashtrimit të bazueshmërisë së akuzës ndaj aktgjykimit të gjykatës, kjo është thjesht njohja e faktit se gjithmonë duhet të ofrohen informata të plota në mënyrë që të bëhet gjykimi. Ruajtja e drejtësisë së procedurave dhe sigurimi i ushtrimit efektiv të të drejtave të mbrojtjes në gjykim mund të kërkojë informata më të plota në një fazë më të hershme.
- Në të vërtetë, neni 6(4) kërkon që të dyshuarit dhe të akuzuarit të njoftohen ‘menjëherë’ për çdo ndryshim në akuzë kur kjo është e nevojshme për ta mbrojtur drejtësinë e procedurës. Kjo e njeh faktin se ndryshimet në akuzë mund të ndikojnë në sjelljen e mbrojtjes dhe se mos-ofrimi i informatave të tilla mund të cenojë këtë drejtësi.
- Përkundër kërkesave të bëra më herët gjatë procedurave për informata më të plota, të cilat do të ishte e mundur të ofroheshin, një gjë e tillë nuk ishte bërë dhe rrjedhimisht direktiva ishte shkelur. Kjo ka cenuar të dyshuarin, p.sh. ai/ajo ka ofruar deklarata të cilat më pas janë përdorur kundër tij/saj.
- Fakti që kjo mund të ketë qenë në përputhje me ligjin kombëtar nuk është vendimtar. Gjykata duhet të sigurojë efektivitet të direktivës dhe të ndërmarrë veprime nëse nuk respektohen standardet e direktivës.
- Në përputhje me rrethanat, gjykata duhet të ndërmarrë veprime për të korrigjuar dështimin e direktivës (duke shpërfillur provat, shpallur aktin si të pavlefshëm, etj.).
- Nëse gjykata ka dyshime lidhur me kuptimin e dispozitave, ajo duhet të bëjë një referencë për vendim paraprak në GJDBE.

## III - QASJA NË DOSJEN E LËNDËS

### A. ÇËSHTJA

---

Një ndër çështjet më së shpeshti të identifikuar në diskutimet e "Fair Trials" me praktikues është problemi që vjen si pasojë e mungesës ose qasjes së kufizuar në fazën e procedurës paraprake për provat materiale që zbulohen nga autoritetet hetuese. Ka disa probleme të raportuara:

- Në pikën e marrjes fillestare në pyetje nga policia dhe/ose hetuesit gjyqësor, as i dyshuari dhe as avokati i tij nuk kanë qasje në dosjen e lëndës, me ç'rast i dyshuari nuk mund të vlerësojë plotësisht provat; kjo kompromenton efektivitetin e të drejtës për ndihmë juridike të parashikuar nga neni 6(3)(c) i KEDNJ-së dhe Direktivën për Qasje në Avokat;
- Në disa juridiksione, qasja në dosjen e lëndës mund të kufizohet gjatë fazës hetimore të procedurës, ose si rregull ose nga zbatimi i kompetencave të jashtëzakonshme në dispozicion të prokurorëve të cilat përdoren në mënyrë rutinore dhe nuk kontrollohen mjaftueshëm nga gjykatat;
- Të dy çështjet e mësipërme kanë ndikim negativ në mundësinë për kundërshtimin e paraburgimit, pasi që nuk është e mundur të kontestohet arsyetimi për arrestim e as të kundërshtohet paraburgimi në mënyrë efektive para autoritetit gjyqësor;
- Edhe në rastet kur ofrohet qasje në dosjen e lëndës, ekzistojnë vështirësi lidhur me mënyrën në të cilën ofrohet qasja. Në disa raste, vetëm avokati mund të mbajë një kopje të dosjes; në raste të tjera, qasja mund t'i ofrohet klientit, por dosja duhet të fotokopjohet dhe shpesh ka një kosto të konsiderueshme. Në raste të tjera, kemi dëgjuar për kufizime në marrje të shënimeve, duke e bërë të pamundur që klienti dhe avokati të diskutojnë përmbajtjen e dokumenteve në fjalë në mënyrë efektive.

### B. BAZA E KEDNJ-së

---

Çështjet lidhur me qasjen në dosjen e lëndës lindin (shprehimisht ose me implikim) në rastet që kanë të bëjnë me nenet 6(3)(a), (b) dhe (c) të KEDNJ-së. Këto përfshijnë, aq sa janë relevante këtu:

*3. Çdo person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale si në vijim:*

*(a) të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai kupton dhe në hollësi, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;*

*(b) të ketë kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;*

*(c) të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës juridike (...);*

GJEDNJ ka zhvilluar parime që kanë të bëjnë me çështjen e qasjes në dosjen e lëndës bazuar në këto nene, përmbajtja e së cilës është disi e vështirë për t'u përcaktuar qartë.

#### 1. Qasja në dosjen e lëndës në fazën e procedurës paraprake

Para së gjithash, GJEDNJ ka folur për lidhjen ndërmjet detyrimit për të ofruar informata për akuzë sipas nenit 6(3)(a) dhe për t'i zbuluar dëshmitë e ndërlidhura, duke deklaruar:

*“njoftimi për akuzë që kërkohet sipas nenit 6(3)(a) nuk duhet domosdoshmërisht të përcillet me zbulimin e provave mbështetëse për të mundësuar që i akuzuari të përgatitet për gjykim (...) Ekzistenca e provave të tilla mund të varet nga rezultatet e një hetimi të vazhdueshëm”.*<sup>46</sup>

Megjithatë, GJEDNJ ka njohur disa kufizime për këtë, sipas nenit 5(4) të KEDNJ-së. Në një linjë të mirë të praktikës gjyqësore, ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se rishikimi gjyqësor i ndalimit para procedurës parapake duhet të jetë i tillë që të sigurojë barazinë e armëve, që kërkon të ofrohet qasje për disa prova:

- *‘Gjykata e pranon nevojën që hetimet penale të kryhen në mënyrë efektive, që mund të nënkuptojë se një pjesë e informatave të mbledhura gjatë këtyre hetimeve duhet të mbahet sekret për t'i parandaluar të dyshuarit që t'i dëmtojnë provat dhe ta dëmtojnë rrjedhën e drejtësisë. Sidoqoftë, ky qëllim legjitim nuk mund të ndiqet në kurriz të kufizimeve substanciale të të drejtave për mbrojtje. Prandaj, informatat të cilat janë thelbësore për vlerësimin e ligjshmërisë së ndalimit të një personi duhet të vihet në dispozicion në një mënyrë të përshtatshme për avokatin e të dyshuarit’.*<sup>47</sup>

Ajo që kurrë nuk është bërë e qartë nga GJEDNJ është faza në të cilën një gjë e tillë duhet të ndodhë. Neni 5(4) ka të bëjë me rishikimin gjyqësor të ndalimit dhe kështu nuk mund të rregullojë çfarë ndodh para asaj kohe. Përderisa neni 5(2) i KEDNJ-së kërkon që një personi t'i ofrohen arsyet për arrestimin e tij, kjo nuk është interpretuar që nënkupton të drejtën për qasje në materialet përkatëse themelore.

Avokatët në disa juridiksione (veçanërisht Francë, Belgjikë dhe Luksemburg) kanë argumentuar se të drejtat e mbrojtura me nenin 6(3) të KEDNJ-së i mundësojnë të dyshuarit//avokatin të tij të kenë qasje në dosjen e policisë para marrjes fillestare në pyetje. Nuk ka mbështetje të qartë për këtë në praktikën gjyqësore. Një deklaratë e përmendur shpesh është ajo që lidhet me rolin e avokatin në stacionin policor. Pas vendimit në rastin [Salduz kundër Turqisë](#), që i ofron avokatin të drejtën për qasje që nga marrja e parë në pyetje nga policia, GJEDNJ diskutoi rolin e avokatin në atë kontekst:

- *‘Në të vërtetë, rregullshmëria e procedurave kërkon që të akuzuarit t'i mundësohet e gjithë gama e shërbimeve të lidhura posaçërisht me ndihmën juridike. Në këtë aspekt, avokati duhet të jetë në gjendje t'i sigurojë pa kufizim aspektet themelore të mbrojtjes së atij personi: diskutimin e çështjes, organizimin e mbrojtjes, mbledhjen e provave të favorshme për të akuzuarin, përgatitjen për marrjen në pyetje, mbështetjen e një të akuzuari në vështirësi dhe kontrollimin e kushteve të ndalimit’.*<sup>48</sup>

<sup>46</sup> Rasti *Haxhia v. Albania*, cituar më lart shënimi 36, paragrafi. 131.

<sup>47</sup> Rasti [Chruściński v. Poland](#), Nr. i ap. 22755/04 (Aktgjykim i 6 nëntorit 2007), paragrafi 56.

<sup>48</sup> Rasti [Dayanan v. Turkey](#), Nr. i ap. 7377/03 (Aktgjykimi i 13 tetorit 2009), paragrafi 32.



Avokatët në këtë kanë vërejtur sugjerimin e paqartë se në mënyrë që ky rol të kryhet në mënyrë efektive, avokati duhet të ketë qasje në dosjen e lëndës. Është e pamundur që roli i gjerë i avokatit të kryhet pa qasje në dosjen e lëndës. Një gjykim e mbështet këtë. Gjetja e shkeljes e së drejtës të avokatit për qasje në fazën e procedurës paraprake, GJEDNJ ka deklaruar:

- *Megjithatë, për gjykatën është se avokatja e parashtruesit nuk ishte lejuar ta shqyrtojë dosjen hetimore në atë pikë (...), gjë që do të pengonte seriozisht aftësinë e saj për të ofruar ndonjë këshillë ligjore kuptimplotë për parashtruesin.<sup>49</sup>*

Deri më sot, kjo pikëpamje nuk është ndarë nga gjykatat e larta. Vendimet e instancave kushtetuese në Francë dhe Belgjikë, ku këto pika janë shqyrtuar gjerësisht, kanë sugjeruar që faza fillestare e marrjes në pyetje të jetë hetuese dhe se panoteka e plotë e garancive të barazisë së armëve nuk zbatohet deri në fazën gjyqësore të kontestuar.

## 2. Qasja në dosjen e lëndës për tu përgatitur për gjykim

GJEDNJ ka nxjerr një numër të gjykimeve në bazë të nenit 6(3)(b) në lidhje me ankesat që mos ofrimi i qasjes në dosjen e lëndës në kohën e duhur para gjykimit ka privuar parashtruesit nga 'koha dhe lehtësirat për të përgatitur mbrojtjen'. GJEDNJ thekson:

- *"Lehtësirat" që do t'u ofrohen të gjithëve që akuzohen për shkelje përfshijnë mundësinë për tu informuar, me qëllim të përgatitjes së mbrojtjes së tyre, me rezultatet e hetimeve të kryera përgjatë gjithë procedurës. Gjykata përsërit se tashmë ka konstatuar se qasja e pakufizuar në dosjen e lëndës dhe përdorimi i pakufizuar i ndonjë shënimi, përfshirë, nëse është e nevojshme, mundësinë e marrjes së kopjeve të dokumenteve përkatëse, janë garanci të rëndësishme për një gjykim të drejtë. Mungesa e qasjes së tillë ka peshuar, në vlerësimin e gjykatës, në favor të konstatimit se parimi i barazisë së armëve është shkelur".<sup>50</sup>*

Megjithatë, GJEDNJ pranon se qasja nuk duhet domosdoshmërisht t'i jepet vetë të akuzuarit:

- *Kufizimi i së drejtës të avokatit të një të akuzuari për të inspektuar dosjen e gjykatës nuk është në përputhje me të drejtat e mbrojtjes sipas nenit 6.<sup>51</sup>*

Megjithatë, ekzistojnë shembuj të ndryshëm të situatave ku kufizimet për qasje në dosjen e lëndës kanë qenë të mjaftueshme për të shkelur nenin 6(3)(b):

- *Pamundësia e qasjes në dosjen e lëndës deri në një fazë të vonshme;<sup>52</sup>*
- *Kufizimi i kohës për përgatitjen e gjykimit në vetëm disa orë;<sup>53</sup>*
- *Dështimi për të siguruar një kopje të një vendimi me qëllim të përgatitjes së një ankimi;<sup>54</sup>*
- *Ofrimi i 20 ditëve për të shqyrtuar një dosje prej 17 000 faqesh, nga të cilat një*

<sup>49</sup> *Sapan v. Turkey*, cituar më lart shënimi 17, paragrafi 21.

<sup>50</sup> Rasti *Beraru v. Romania*, Nr. i ap. 40107/04 (Aktgjykimi i 18 majit 2014), paragrafët 69-70.

<sup>51</sup> Rasti *Kremzow v. Austria*, Nr. i ap. 12350/86 (Aktgjykimi i 21 shtatorit 1993), paragrafi 52

<sup>52</sup> *Beraru v. Romania*, cituar më lart shënimi 50, paragrafi 70.

<sup>53</sup> *Vyerentsov v. Ukraine*, cituar më lart shënimi 16, paragrafët 73-76

<sup>54</sup> Case of *Chorniy v. Ukraine*, Nr. i ap. 35227/06 (Aktgjykimi i 16 majit 2013), paragrafi 43.



*javë është shpenzuar për fotokopjimin e dosjes,<sup>55</sup> Në të kundërt, 21 ditë për të shqyrtuar 49 faqe rezultoi me asnjë shkelje<sup>56</sup>;*

- *Kufizimet ndaj avokatëve për t'ia komunikuar dokumentet në dosje të dyshuarit ose për ta përfshirë atë në analizën e këtyre dokumenteve, në rrethanat kur parashtruesi mund të ketë pasur komente për të bërë lidhur me përmbajtjen e tyre,<sup>57</sup> dhe*

- *Leximi nga prokurorët, në një seancë gjyqësore përfundimtare në një rast të ndërlikuar të mashtrimit, i dokumenteve që ishin material për rastin, kombinuar me refuzimin e një shtyrje për t'i mundësuar mbrojtjes t'i studionte këto dokumente.<sup>58</sup>*

### C. DISPOZITAT PËRKATËSE TË DIREKTIVËS

Direktiva mbulon çështjen e qasjes në dosjen e lëndës përmes nenit 7, që parasheh:

“1. Kur një person arrestohet dhe ndalohet në çfarëdo faza të procedurës penale, Shtetet Anëtare sigurojnë që dokumentet në lidhje me rastin specifik në posedim të autoriteteve kompetente të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar në mënyrë efektive, në përputhje me ligjin kombëtar, ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit, vihen në dispozicion të personave të arrestuar ose avokatëve të tyre.

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që të paktën të gjitha provat materiale në posedim të autoriteteve kompetente, qoftë për ose kundër personave të dyshuar ose të akuzuar, u sigurohen këtyre personave ose avokatëve të tyre me qëllim të mbrojtjes së rregullshmërisë së procedurës dhe përgatitjes së mbrojtjes.

3. Pa cenuar paragrafin 1, qasja në materialet e përmendura në paragrafin 2 ofrohet në kohën e duhur në mënyrë që të mundësohet ushtrimi efektiv i të drejtave të mbrojtjes dhe më së voni pas dorëzimit të bazueshmërisë së akuzës në gjykatë. Kur autoritetet kompetente marrin në posedim dëshmitë e mëtejshme materiale, qasja në to ofrohet në kohën e duhur në mënyrë që të mundësohet shqyrtimi i tyre.

4. Përmes përjashtim nga paragrafët 2 dhe 3, përderisa nuk cenohet e drejta për gjykim të drejtë, qasja në materiale të caktuara mund të refuzohet nëse qasja e tillë mund të kërcënojë seriozisht jetën ose të drejtat themelore të një personi tjetër ose nëse refuzimi i tillë është rreptësisht i domosdoshëm për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik, si në rastet kur qasja mund të cenojë një hetim të vazhdueshëm ose të dëmtojë seriozisht sigurinë kombëtare të shtetit anëtar në të cilin kanë filluar procedimet penale. Shtetet anëtare sigurojnë që, në përputhje me procedurat në të drejtën kombëtare, vendimi për refuzimin e qasjes në

<sup>55</sup> *Öcalan v. Turkey*, cituar më lart shënimi 16, paragrafi 142.

<sup>56</sup> *Kremzow v. Austria*, cituar më lart shënimi 51, paragrafi 48.

<sup>57</sup> *Öcalan v. Turkey*, cituar më lart shënimi 16, paragrafi 147.

<sup>58</sup> Rasti i [Gregacevic v. Croatia](#), Nr. i ap. 58331/09 (Aktgjykimi i 10 korrikut 2012), paragrafi 57.

materiale të caktuara, në pajtim me këtë paragraf, merret nga një autoritet gjyqësor ose të paktën i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.

5. Qasja, siç referohet në këtë nen, ofrohet pa pagesë.'

Sikurse në nenin 6, këto dispozita janë interpretuar në disa mënyra të mundshme dhe do të duhet të qartësohen nga GJDBE-ja. Këto do t'i shqyrtojmë gjatë shqyrtimit të çështjeve të ndryshme që lidhen me qasjen në dosjen e lëndës, të cilat janë diskutuar më sipër.

## D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË

---

### 1. Qasja në dosjen e lëndës në fazën e marrjes në pyetje

#### a. Debati lidhur me kërkesat e nenit 7(1)

Se a kërkon neni 7(1) qasje në dosjen e lëndës në stacionin e policisë është një lloj “teme e nxehtë” në kohën e shkrimit të këtij dokumenti. Grupet e organizuara të avokatëve në Francë dhe Spanjë besojnë se kjo dispozitë nënkupton të drejtën e qasjes në dosjen (e policisë) e cila është thelbësore për t'i mundësuar të dyshuarit, përmes avokatit të tij, të kontestojë bazat për arrestimin e personit, fillimisht në stacionin e policisë.

Gjykatat e larta ende nuk kanë vendosur për këtë. Ekzistojnë shqetësime midis policisë dhe prokurorëve sa i përket ndikimit të mundshëm të kërkesës për të ofruar dëshmi në këtë fazë, në veçanti pasi ajo mund të çojë në vonesa të cilat do të shfrytëzonin kohën e çmuar në një periudhë të kufizuar zakonisht në mes 24 dhe 72 orë para se personi duhet të sillet para një gjyqtari. Dyshimi lind gjithashtu nga deklaimimi 30, i cili parasheh:

“Dokumentet, fotografitë, regjistrimet audio dhe video, sipas rastit, të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar në mënyrë efektive ligjshmërinë e arrestimit ose paraburgimit të personave të dyshuar ose të akuzuar në përputhje me ligjin kombëtar, duhet të vihen në dispozicion të personave të dyshuar apo të akuzuar ose avokatëve të tyre më së voni para se autoriteti kompetent gjyqësor të thirret për të vendosur mbi ligjshmërinë e arrestimit ose paraburgimit në përputhje me nenin 5(4) të KEDNJ-së”

Përderisa specifikimi i llojit të materialit mund të jetë i dobishëm, referimi në nenin 5(4) të KEDNJ-së sugjeron që qasja në këtë material të bëhet domosdoshmërisht e nevojshme vetëm në momentin kur arrestimi shqyrtohet në mënyrë gjyqësore, gjë që nuk do të nënkuptonte ndonjë zhvillim të pozitës së GJEDNJ-së (shih f. 33 më lart)).

#### b. Pikëpamja e “Fair Trials”: neni 7(1) kërkon qasje në momentin e marrjes në pyetje

“Fair Trials” ju inkurajon ta shqyrtoni gjerësisht nenin 7(1). Ne besojmë se në thelb çështja e ofrimit të dokumenteve pas arrestimit është subjekt i një keqkuptimi të përgjithshëm për shkak të mbulueshmërisë së kufizuar nga praktika gjyqësore e nenit 6 të GJEDNJ-së. Neni 6 ekziston për ta mbrojtur rregullshmërinë e gjyqësorit dhe kërkesa e “barazisë së armëve” zbatohet në gjyq; procedura paraprake bie brenda fushëveprimit të nenit 6 vetëm deri në masën që ajo ndikon në rregullshmërinë e procedurës, duke kufizuar masën në të cilën shpalosja në stacionin policor mund të hyjë në shqyrtimin e GJEDNJ-së. Neni 5(4) kufizohet në shqyrtimin gjyqësor të arrestimit fillestar dhe mund të kërkojë “barazinë e armëve” vetëm në atë fazë. Si rezultat, është krijuar një pikëpamje e përgjithshme se “barazia e armëve” është në thelb karakteristikë e procedurës gjyqësore dhe se policia është e lirë të mos shpalos dëshmitë dhe të përdorë fazën e pyetjeve thjesht si mundësi për hetim.

Kjo injoron faktin se policisë i është deleguar autoriteti publik që të ndërhyjnë në lirinë e një personi, gjë të cilën personi ka të drejtë ta kundërshtojë. Fair Trials sugjeron se marrja në pyetje në fazën fillestare është, përveç një akti hetimor, gjithashtu edhe momenti në të cilin

ky autoritet duhet t'i ofrojë personit njohuri të mjaftueshme për bazat e arrestimit të tij, ashtu që t'i mundësoj atij krijimin e një qëndrimit se a do të flas dhe të bëj pikëpamjet e tij të ditura apo të kundërshtoj arrestimin në gjykatë. Në mënyrë që kjo të jetë mundësi e dobishme, arsyet për arrestimin dhe provat kryesore duhet të vihen në dispozicion.

Neni 7(1) nuk bën të njëjtën dallim ndërmjet fazës gjyqësore dhe fazës fillestare, si dhe duhet të lexohet si kërkesë për qasje në dosjen e lëndës në fazën e marrjes fillestare në pyetje:

- Neni 7(1) i referohet një personi që “është arrestuar ose ndaluar”, “në çfarëdo faze të procedurës penale”. Duket se theksi është vendosur qëllimshëm mbi mbulimin e gjithë procedurës në lidhje me heqjen e lirisë, që përfshin arrestimin fillestar.
- Neni 7(1) identifikon dokumentet që duhet të vihen në dispozicion: ato që janë të nevojshme për kundërshtimin e arrestimit ose paraburgim në mënyrë efektive. Në rastin e një arrestimi fillestar, kjo mund t'i referohet vetëm dëshmimeve që konsiderohen se përbëjnë baza të ligjshme për ndërhyrje në lirinë e personit (d.m.th. dyshim i arsyeshëm për një shkelje).
- Ndonëse është e vërtetë që deklamimi 30 sugjeron që dokumentet e nevojshme duhet të vihen në dispozicion më së voni pas shqyrtimit gjyqësor të paraburgimit, kjo thjesht është pasqyrim i një standardi minimal ekzistues të pakthyesëm të përcaktuar nga KEDNJ sipas nenit 5(4). Në fakt, direktiva parasheh qasje në dokumente të tilla më herët, siç tregohet me shprehjen “më së voni”.
- Në traditën e së drejtës së BE-së, respektimi i të drejtave të mbrojtjes që parashihen në nenin 48 të Kartës është i një rëndësie të lartë në miratimin e vendimeve që prekin një individ. Të drejtat e mbrojtjes përfshijnë të drejtën për t'u dëgjuar, gjë që kërkon qasje në dosjen e lëndës, siç paraqitet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për të drejtat e mbrojtjes. Gjykata e Përgjithshme e BE-së ka deklaruar:

“Parimi i respektimit të të drejtave të mbrojtjes kërkon, para se gjithash, që subjekti i interesuar të informohet për provat e paraqitura kundër tij për të justifikuar masën që ndikon negativisht në të. Së dyti, duhet t'i jepet mundësia që në mënyrë efektive të bëjë të njohur pikëpamjen e tij për atë dëshmi (...). Rrjedhimisht (...) dëshmitë e paraqitura ndaj atij subjekti duhet t'i zbulohen atij ose në të njëjtën kohë me miratimin e masës përkatëse ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas miratimit të masës përkatëse”<sup>59</sup>

- Përderisa konteksti është i ndryshëm (këto raste kanë të bëjnë me miratimin e masave kufizuese nga institucionet e BE-së), kjo qasje tregon se, nga perspektiva e Kartës, të drejtat e mbrojtjes, duke përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, mbrohen gjatë fazës administrative, para shqyrtimit pasues gjyqësor. Autoriteti administrativ, i cili kërkohet të veprojë në mënyrë të ligjshme, duhet t'i dëgjojë pikëpamjet e personit të prekur në lidhje me bazat substanciale të vendimit.
- Kjo duhet të zbatohet *a fortiori* kur personi privohet nga liria e tij. Personi i arrestuar ka të drejtë të informohet për arsyet e arrestimit të tij sipas nenit 6(2) dhe për provat që vërtetojnë këto arsye sipas nenit 7(1). Kjo i mundëson personit, përmes avokatit të tij, të krijojë një pikëpamje për ligjshmërinë e arrestimit dhe të vendosë nëse do t'i bëjë të njohura pikëpamjet e tij ose të ushtrojë të drejtën për të heshtur dhe për të kundërshtuar arrestimin me anë të shqyrtimit gjyqësor. Fakti që ky kombinim i arsyeve dhe materialeve nuk paraqitet qartë (ende) në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nuk është përcaktues, pasi që direktiva nuk kufizohet nga kjo e fundit dhe si e tillë synon të ndërtoj atë.

Këto janë vetëm disa ide, dhe ju jeni padyshim të lirë t'i modifikoni argumentet tuaja. Pasi të jeni të kënaqur me bazën që e krijoni për kërkimin e të drejtës për qasje në lëndët e rastit në stacionin e policisë, procesi i thirrjes në këtë të drejtë është i thjeshtë:

<sup>59</sup> Rasti T-496/10 *Bank Mellat v Council* [ECLI:EU:T:2013:39](#), paragrafi 53.

- Merrni veprime në fazën e procedurës paraprake, nëse jeni aty
- Këmbëngulni që të iu sigurohet qasja në lëndë e rastit para marrjes në pyetje nga ana e policisë, prokurorit ose gjykatësit hetues, duke përmendur se ju mbështeteni në direktivë;
- Shpjegoni se kjo qasje është e nevojshme në mënyrë që t'ju mundësojë ta vlerësoni ligjshmërinë e arrestimit dhe t'i mundësojë klientit tuaj t'i bëjë të njohura pikëpamjet e tij mbi përmbajtjen e pretendimit, duke iu nënshtruar të drejtës së tij për të heshtur;
- Sigurohuni që kërkesa juaj të regjistrohet në çdo protokoll policie, duke përmendur direktivën. Nëse nuk ofrohet qasja, merrni parasysh të këshilloni heshtje derisa përmbajtja e dosjes të jetë ofruar, si dhe sigurohuni që arsyet për refuzimin e qasjes të regjistrohen. Shpjegoni se si ky refuzim po zvogëlon aftësinë tuaj për të këshilluar klientin në mënyrë të dobishme dhe po detyron klientin të marrë vendime pa njohuri të mjaftueshme për pasojat e mundshme.
- Ndërmerrni masa për të kundërshtuar shkeljen në gjykatë nëse nuk u jepet qasja në përputhje me qasjen e përgjithshme të përcaktuar në Manualin 'Përdorimi i së drejtës të BE-së'.
- Shpjegoni në gjykatë se pse besoni se neni 7(1) siguron të drejtën e qasjes në dosjen e lëndës para marrjes në pyetje;
- Vërtetoni që e drejta e qasjes nuk është ofruar në përputhje me atë kërkesë (kjo duhet të jetë e thjeshtë nëse rregullat procedurale nuk lejojnë qasje në dosjen e lëndës në këtë fazë, prandaj mohimi i qasjes është thjesht zbatim i procedurës së zakonshme).
- Tregoni se pse kjo ka dëmtoar interesat e klientit tuaj. Nëse keni arsye për të kërkuar një mjet juridik (p.sh., është bërë rrëfimi ose nuk është ushtruar e drejta për heshtje), kjo mund të jetë e vetëkuptueshme.
- Në bazë të shkeljes së direktivës, kërkonte zbatimin e një mjeti juridik (pavlefshmëria e aktit, përjashtimi i provave, etj..).
- Tregoni gjykatës informata mbi diskutimin e nenit 7(1) në juridiksione të ndryshme, duke demonstruar se është një çështje që ka nevojë për sqarime dhe sugjeroni që gjykata të kërkojë një referencë për vendimin paraprak në GJDBE.

## 2. Qasja në dosjen e lëndës dhe shqyrtimi efektiv gjyqësor i arrestimit/paraburgimit

Sfida më e drejtpërdrejtë ka të bëjë me sigurimin e qasjes në dosjen e lëndës pas marrjes fillestare në pyetje, përderisa hetimi zhvillohet. Në këtë drejtim, pika fillestare është neni 5(4) i KEDNJ-së, i cili, siç e kemi parë, kërkon qasje në ato materiale që janë të nevojshme për të kundërshtuar paraburgimin me qëllim që të sigurohet barazi e armëve në shqyrtimin gjyqësor.

Pavarësisht nga natyra relativisht e qartë e praktikës gjyqësore në nenin 5(4), respektimi i këtij standardi nuk ka qenë gjithmonë shumë i mirë, me disa ligje dhe praktika që mundësojnë kufizime në qasjen në dosje edhe kur personi është i paraburgosur. Kodi procedural i Estonisë, për shembull, parashikon të drejtën e qasjes në dokumentet e nevojshme për të kundërshtuar paraburgimin, por i mundëson prokurorit ta kufizojë këtë të

drejtë për arsye më të rëndësishme. Madje edhe kur çështja duket se është zgjidhur nga legjislacioni, problemet mund të vazhdojnë në praktikë. Në Poloni, për shembull, dispozitat e reja kërkojnë që prokurori t'i zbulojë provat e përmendura në mocionin e paraburgimit, gjë që mund të rrezikojë që disa prova materiale të mos përmenden dhe as të mos vihen në dispozicion. Ne shikojmë se si ta përdorim nenin 7(1) për të trajtuar këtë.

#### a. Pika fillestare: neni 7(1) nuk i nënshtrohet asnjë derogimi

Pika e parë që duhet theksuar është se neni 7(1) nuk i nënshtrohet asnjë derogimi. Neni 7(4) parasheh bazat për kufizimin e qasjes në dëshmitë materiale, por thekson në mënyrë specifike se kjo vlen vetëm si derogim ndaj nenit 7(2) dhe (3). Këto dispozita, të diskutuara në vijim, kanë të bëjnë me zbulimin e provave materiale përtej asaj që është e nevojshme për të kundërshtuar paraburgimin dhe që vet ato shprehen si “pa cenuar [nenin 7(1)]”. Neni 7(1) nuk njihet asnjë derogim.

Kjo është në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së mbi nenin 5(4), e cila ka pranuar se edhe nëse prova është konfidenciale për arsye të sigurisë kombëtare, mbrojtja e atij materiali nuk mund të vijë në kurriz të kufizimeve substanciale për të drejtat e mbrojtjes dhe dëshmitë relevante do të duhet të zbulohen, ndoshta me kompensime të bëra për natyrën e saj konfidenciale.<sup>60</sup>

#### b. Kundërshtimi i kufizimit ligjor të qasjes

Supozoni se keni të bëni me një masë legjislative që i mundëson prokurorit të kufizojë qasjen në dosjen e lëndës në fazën e procedurës paraprake. Praktika e mëparshme e brendshme e njëjtit si të lejueshme nëse ekzistojnë baza të mjaftueshme. Çfarë duhet të bëni?

- ➔ Përzgjidhni forumin tuaj (kjo mund të jetë: (i) kundërshtim/ankesë gjyqësore ndaj një kërkesë të refuzuar për zbulim drejtuar prokurorit; (ii) kërkesë/rekurs para gjyqtarit të procedurës paraprake; ose (iii) thjesht një kërkesë e bërë ndaj gjykatësit të procedurës paraprake për paraburgim).
- Argumentoni: Neni 7(1) pa dyshim riprodhon standardin e nenit 5(4) të KEDNJ-së, i cili është interpretuar nga një linjë e qartë e praktikës gjyqësore si i tillë që kërkon qasje në dokumentet e nevojshme për të kundërshtuar paraburgimin. Neni 7(1) ka efekt të drejtpërdrejtë dhe nuk i nënshtrohet ndonjë derogimi. Rrjedhimisht, as që mund të bëhet fjalë për kufizim të qasjes në dokumentet kryesore të cilat janë materiale për vendimin e paraburgimit. Deri në masën që prokuroria përpiqet të mbështetet në kompetencat në dispozicion sipas ligjit kombëtar, zbatimi i të cilit do të çonte në kufizimin e të drejtave të nenit 7(1), dispozitat përkatëse të së drejtës kombëtare duhet të anulohen dhe qasja duhet të sigurohet. Nëse dispozitat janë diskrecionale, neni 7(1) zvogëlon atë diskrecion në zero.

#### c. Kundërshtimi i kufizimit “prokurori vendos”

<sup>60</sup> Rasti i [Dochnal kundër Polonisë](#), Nr. i ap. 31622/07 (Aktgjykimi i 18 shtatorit 2012), paragrafi 87.

Konsideroni problemin e një natyre më praktike, p.sh. disa dëshmi ju janë shpalosur nga prokurori për t'i vërtetuar pikat e bëra në kërkesën për paraburgim, por në dosje mund të ketë informata tjera që janë relevante. Çfarë duhet të bëni?

- Përzgjidhni forumin tuaj (kjo mund të jetë: (i) kundërshtim/ankesë gjyqësore ndaj një kërkesë të refuzuar për zbulim drejtuar prokurorit; (ii) kërkesë/rekurs para gjyqtarit të procedurës paraprake; ose (iii) thjesht një kërkesë e bërë ndaj gjykatësit të procedurës paraprake për paraburgim).
- Argument: Neni 7(1) ka efekt të drejtpërdrejtë dhe kërkon qasje në dokumente të cilat janë të nevojshme për të kundërshtuar në mënyrë efektive paraburgimin. Qëllimi i kësaj dispozite është që të sigurohet se vendimi i paraburgimit nuk merret në bazë të provave që nuk shihen nga personi i ndaluar dhe se provat që mbahen kundër paraburgimit nuk anashkalojnë për shkak të pamundësisë së dyshuarit për të bazuar argumente mbi të. Qasja duhet të sigurohet jo vetëm për dokumentet e përmendura nga prokurori, por edhe për dokumente tjera që gjykata i konsideron të kenë ndikim në vendimin e saj. Kjo do të thotë që gjykata duhet të marrë parasysh mocionin e vet nëse ka pjesë tjera të dosjes që lidhen me vendimin e saj dhe të sigurojë që këto dorëzohen në mbrojtje.
- Në bazë të kësaj që u tha më sipër, me qëllim që të sigurohet respektimi i Kartës për të drejtën e lirisë (neni 6), i cili përfshin detyrimet e shqyrtimit gjyqësor në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjykata duhet të përjashtojë prokurorinë duke u mbështetur në provat që nuk janë zbuluar dhe të urdhëroj zbulimin e provave tjera që i konsideron materiale.



### 3. Qasja në dosjen e lëndës në fazën e procedurës paraprake - pavarësisht nga paraburgimi

#### a. Mangësia në praktikën gjyqësore të KEDNJ-së

A e parasheh direktiva të drejtën e qasjes në dosjen e lëndës në fazën e procedurës paraprake, pa marr parasysh arrestimin e klientit? Siç shihet më lart, GJEDNJ-ja ka pranuar se kufizimet praktike për “kohën dhe lehtësirat për përgatitjen e mbrojtjes” para gjykimit mund të çojnë në shkelje të nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së, nëse e bëjnë të pamundur përgatitjen për gjykat.<sup>61</sup> Megjithatë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së nuk është shumë e dobishme në lidhje me kërkimin e qasjes në dosjen e lëndës në një fazë më të hershme gjatë procedurës.

Praktika gjyqësore tregon se njoftimi i akuzave, i cili duhet të ndodhë më herët në procedurë, “nuk duhet domosdoshmërisht të ndiqet nga zbulimi i provave mbështetëse për t'i mundësuar të akuzuarit të përgatitet për gjykim (...) Ekzistenca e provave të tilla ende mund të varet nga rezultatet e një hetimi që është duke vazhduar”.<sup>62</sup> Përderisa kjo sugjeron që kufizimet në qasje duhet të justifikohen nga arsyet që lidhen me hetimin, ka pak bazë për GJEDNJ që t'i komentojë kufizimet e procedurës paraprake. E gjitha ajo që mund të bëjë është të përcaktojë, pas përfundimit të procedurave, nëse ndonjë kufizim në qasjen në dosjen e lëndës ka cenuar rregullshmërinë e procedurës si tërësi. Ajo mund t'i komentojë kufizimet e paraburgimit në masën që ato ndërhyjnë në të drejtën për shqyrtimin efektiv gjyqësor të paraburgimit sipas nenit 5(4) të KEDNJ-së, por ekziston një “mangësi” në praktikën gjyqësore të nenit 6.

#### b. Pikëpamja e "Fair Trials": Neni 7(2) kërkon qasje gjatë procedurës paraprake, duke iu nënshtuar zbatimit të përjashtimeve të verifikueshme gjyqësore

Ne besojmë që qëndrimi i shprehur në direktivë është më i dobishëm:

- Në bazë të nenit 7(3), e drejta për qasje në të gjitha provat materiale sipas nenit 7(2) shprehet si duke u zbatuar “më së voni” me dorëzimin e bazueshmërisë së akuzës në gjykatë. Kjo reflekton faktin se në momentin e gjykimit, “barazia e plotë e armëve” duhet të sigurohet. Megjithatë, rregulli i përmendur në nenin 7(3) është që qasja e tillë duhet të sigurohet “në kohën e duhur për të lejuar ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes”, dhe asgjë nuk e pengon që kjo të thirret në fazën e procedurës paraprake.

<sup>61</sup> Rasti *Iglin v. Ukraine*, përmendur më lart shënimi 16, paragrafi 60 ; Rasti *Vyerentsov v. Ukraine*, përmendur më lart shënimi 16, paragrafët 73-76;

Rasti *Öcalan v. Turkey*, përmendur më lart shënimi 16, paragrafi 142.

<sup>62</sup> Rasti *Haxhia v. Albania*, përmendur më lart shënimi 36, paragrafi 131.

- Sigurisht, neni 7(4) njeh mundësinë e kufizimit të qasjes së tillë kur kjo “mund të cenoj një hetim që është duke vazhduar”.<sup>63</sup> Megjithatë, vendimi që thirret në këtë dispozitë duhet të merret nga një gjyqtar, ose përmes shqyrtimit gjyqësor. Duke e kombinuar me nenin 8(2) të direktivës, kjo krijon një bazë ligjore për mbikëqyrjen gjyqësore të qasjes në dosjen e lëndës në fazën e procedurës paraprake, e cila nuk ekziston në mënyrë të pavarur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Mbi këtë bazë pushon juridiksioni i gjykatës mbi fazën e procedurës paraprake, ose mbi prokurorin përgjegjës për fazën e procedurës paraprake.
- Kjo siguron një forum brenda të cilit duhet marrë vendimi për qasjen në dosjen e lëndës në pajtim me direktivën. Ju mund të bëni argumente bazuar në nocionin e “ushtrimit të të drejtave të mbrojtjes”. Veçanërisht, mund të dëshironi t'i referoheni të “gjithë gamës së shërbimeve” të lidhura me ndihmën juridike të njohur nga GJEDNJ, duke përfshirë “diskutimin e çështjes” dhe “mbledhjen e provave të favorshme për të akuzuarit”. Këto janë me interes për mbrojtjen në fazën e procedurës paraprake, gjë që mund të jetë e vështirë pa qasje në dosjen e lëndës.

Mbi këtë bazë ne do t'i ofrojmë këshillat e mëposhtme:

- Bëni një kërkesë para gjykatës që ka juridiksion mbi fazën e procedurës paraprake (p.sh. gjykatësi hetues, gjykata që ka juridiksion mbi prokurorinë) për të kërkuar qasje në dosje ose për të kundërshtuar refuzimin për të siguruar qasje në dosjen e lëndës.
- Argumentoni: Neni 7(2), në parim, ju siguron të drejtën e qasjes në të gjitha provat materiale. Në përputhje me nenin 7(3), kjo duhet të sigurohet në kohën e duhur për t'i ushtruar të drejtat e mbrojtjes. Ushtrimi i të drejtave të mbrojtjes përfshin reagimin ndaj hapave të ndërmarrë nga autoritetet hetuese në fazën e procedurës paraprake, duke përfshirë sigurimin e provave shfajësuese, përshtatjen e strategjisë së mbrojtjes ose madje kërkimin e shkarkimit të rastit nëse kjo është e disponueshme sipas ligjit kombëtar.
- E drejta e qasjes në dosjen e lëndës mund të kufizohet në bazë të nenit 7(4), veçanërisht në lidhje me nevojat e një hetimi të vazhdueshëm. Megjithatë, duhet të ekzistojë një nevojë e vërtetë për hetimin që justifikon mos-ofrimin e informatave dhe kufizimi i qasjes në dosjen e lëndës duhet të mbahet në minimumin e nevojshëm për të plotësuar këtë nevojë.
- Kjo nënkupton një kërkesë nga autoriteti për të justifikuar refuzimin e qasjes duke iu referuar elementeve konkrete dhe të argumentuara që justifikojnë zbatimin e këtij kufizimi të atillë që të mundësojë një shqyrtim efektiv gjyqësor ose nëse autoriteti është gjykatës, për të motivuar vendimin e tij duke iu referuar çështjeve të tilla.
- Kompetencat në dispozicion sipas ligjit kombëtar për prokurorët/gjykatën që të kufizoj qasjen në dosjen e lëndës mbi baza të caktuara të lidhura me nevojat e hetimit (p.sh. neni 302 i kodit spanjoll, neni 34 i kodit estonez, neni 156 i kodit polak) duhen të interpretohen në vazhden e këtij detyrimi.
- Identifikoni dhe rendisni në kërkesë, për aq sa është e mundur, dokumentet ose materialet e mundshme që mund të jenë me interes. Shpjegoni se si mos-ofrimi i këtyre dokumenteve dëmton ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes, p.sh. kundërshtimin e ligjshmërisë së hapave hetues.
- Tregoni gjykatësit/gjykatës, kur kundërshtoni vendimin e një prokurori, se është e mundur të bëhet referencë në GJDBE në lidhje me kërkesat e nenit 7 të direktivës. Shih Manualin ‘Përdorimi i të drejtës së BE-së’ për më shumë informacion mbi procesin.

<sup>63</sup> Ky përjashtim duhet lexuar në mënyrë të kufizuar: shih paragrafin 32 të Direktivës për të Drejtën në Informata.

#### 4. Qasja në dosjen e lëndës për tu përgatitur për gjykim

Në çdo rast, neni 7(3) kërkon që të sigurohet qasja në prova materiale pas dorëzimit të bazueshmërisë së akuzës në gjykatë dhe në kohën e duhur për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes në fazën e gjyimit. Ne do të sugjeronim që objektivi këtu është të shmangen situatat të cilat më vonë njihen si shkelje të nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së për shkak të mos-ofrimit të kohës dhe lehtësirave për të përgatitur një mbrojtje.

Kjo kërkesë mund të thirret në bazë të nenit 8(2), duke kërkuar që të mundësohet e drejta e kundërshtimit. Është e qartë se kjo kërkesë ka kuptim vetëm nëse lexohet kundrejt detyrimit të përgjithshëm të shteteve anëtare që të sigurojnë mjete efektive në lidhje me shkeljet e të drejtave të BE-së, një parim i përgjithshëm i së drejtës së BE-së i artikuluar në nenin 47 të Kartës. Duke u bazuar në këtë parim, duhet të kërkonim një mjet ligjor për të parandaluar shkeljen e direktivës (p.sh. sigurimi i mbylljes së rastit) ose të kërkonim një zgjidhje retroaktive (p.sh. rigjykimi, mundësia që në mënyrë efektive t'i komentoni provat në fazën e apelit, ose prishjen e vendimit për dënim të marrë pa u ofruar provat në kohë të duhur).

Bazuar në këto konkluzione në lidhje me kuptimin e tekstit – këto janë konkluzionet tona, në pritje të interpretimit të dispozitës nga GJDBE-ja – ne do t'i sugjeronim hapat e mëposhtëm për t'u mbështetur në direktivë në këtë kontekst.

- ➔ Identifikoni kufizimin për të cilin dëshironi të ankoheni dhe tregoni, praktikisht se si kjo po kufizon aftësinë tuaj për t'u përgatitur për gjykim. Mund të jetë e vlefshme që ta ndërlidhni këtë me shembuj të shkeljeve të nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së siç janë ato të detajuara më lart, pasi kjo do të tregojë se ju keni argumentim të fortë për kërkesën tuaj.
- Kërkonim mjetin ligjor parandalues, nëse kjo është në dispozicion (p.sh. pezullimin), ose mjetin korrektues (ankesë, etj.) në bazë të nenit 8(2) të direktivës.

# IV - DËSHMITARËT DHE PERSONAT TJERË JO TË DYSHUAR

## A. ÇËSHTJA

---

Praktikuesit shpesh raportojnë se dëmi domethënës mund t'i shkaktohet mbrojtjes së një personi të dyshuar ose të akuzuar nga forma të ndryshme jo-formale të marrjes në pyetje, të cilat mund të ndodhin para se të fitojnë atë status zyrtarisht. Në veçanti, deklaratat inkriminuese mund të bëhen nga personi në një kontekst joformal, të cilat ose mbahen zyrtarisht kundër tij, nëse kjo është e lejueshme, ose të paktën mund të ndikojë në zhvillimin e hetimit në të ardhmen.

## B. BAZA E KEDNJ-së

---

### 1. Koncepti i të qenit i “akuzuar”

Neni 6 i KEDNJ-së i jep të drejta personit në fazën e procedurës paraprake me qëllim që të sigurojë rregullshmërinë e procedurës në tërësi. Deklarata standarde është se këto garanci bëhen të zbatueshme kur një person “akuzohet” brenda kuptimit të nenit 6. Kjo mund të ndodh në një moment para se ai person të bëhet formalisht i dyshuar brenda kuptimit të së drejtës kombëtare. GJEDNJ parasheh:

*Që ky koncept është “autonom”; duhet të kuptohet brenda kuptimit të Konventës dhe jo vetëm brenda kuptimit të saj në ligjin kombëtar. Mund të përkufizohet si “njoftim zyrtar që i jepet një personi nga autoriteti kompetent për pretendimin se ai person ka kryer një vepër penale”, një përkufizim që gjithashtu korrespondon me testin nëse “gjendja e [të dyshuarit] është prekur ndjeshëm” (...). Një “akuzë” në disa raste mund të marrë formën e masave tjera që mbartin implikimin e një pretendimi të tillë dhe që gjithashtu ndikojnë në masë të konsiderueshme në situatën e të dyshuarit (...). Legjisllacioni i shtetit në fjalë është padyshim relevant, por nuk ofron më shumë se një pikënisje (...) Pozita dominuese e së drejtës për gjykim të drejtë, në një shoqëri demokratike, favorizon konceptimin “substancial” krahas një konceptimi “formal” të “akuzës” të përmendur në nenin 6; kjo e detyron gjykatën të shikojë prapa paraqitjeve dhe ta shqyrtojë realitetin e procedurës në fjalë për të përcaktuar nëse ka pasur një “akuzë” brenda kuptimit të nenit 6 (...). Në veçanti, gjendja e parashtruesit sipas rregullave të brendshme ligjore në fuqi duhet të shqyrtohet në vazhden e objektit dhe qëllimit të nenit 6, përkatësisht ruajtjes së të drejtave të mbrojtjes.<sup>64</sup>*

### 2. Dëshmitarët që janë/bëhen të dyshuar

Duke zbatuar qasjen e mësipërme, GJEDNJ ka lëvizur drejt njohjes se kur autoritetet kanë arsye bindëse për të dyshuar për një person, ata bëhen ‘të akuzuar’ brenda këtij përkufizimi, në mënyrë që ata t'i fitojnë të drejtat për mbrojtje. Në vijim është paraqitur një ri-përkufizim i kohëve të fundit

---

<sup>64</sup>Rasti i [Mikolajova v. Slovakia](#), Nr. i ap. 4479/03 (Aktgjykimi i 18 janarit 2011), paragrafët 40-41.

lidhur me këtë:

*Gjykata konsideron që një person fiton statusin e të dyshuarit duke bërë thirrje për zbatimin e masave mbrojtëse të nenit 6 jo kur ai status i është caktuar zyrtarisht atij ose asaj, por kur autoritetet vendore kanë arsye bindëse që të dyshojnë se personi është përfshirë në një vepër penale (...)<sup>65</sup>*

Kjo qasje fillimisht ka rrjedhur nga rasti i *Brusco kundër Francës*<sup>66</sup>, i cili lidhet me dispozitat e vjetra të ligjit të cilat janë ndryshuar prej kohësh.

*Një person u thirr me urdhër gjyqësor për t'u paraqitur si dëshmitar dhe u mbajtur në kujdestari nga policia për t'u marrë në pyetje, ndërkohë që, sipas ligjit të brendshëm, kishte status të dëshmitarit. GJEDNJ vuri në dukje se, në këtë pikë, dëshmia e dëshmitarëve të tjerë tashmë ka dhënë arsye për të dyshuar se aplikanti është përfshirë në kryerjen e veprës penale, dhe se kur është thirrur të paraqitet dhe është mbajtur për t'u marrë në pyetje, ai ishte 'i akuzuar' brenda kuptimit të nenit 6, pavarësisht se kishte statusin formal vetëm të një dëshmitari në ligjin kombëtar. Prandaj, dështimi për ta njoftuar atë për të drejtën e tij për heshtje ka shkelur nenin 6.*

Duke zbatuar këtë qasje, GJEDNJ konstaton shkelje të nenit 6 kur një deklaratë inkriminuese e bërë nga një person në kontekstin në të cilin gjendeshin, në mënyrë objektive nën dyshim, por kur nuk informohen për të drejtat e tyre për ndihmë juridike dhe heshtja përdoret kundër tyre për të bazuar dënimin; në të kundërt, kur një pranim bëhet tërësisht vullnetarisht, në rrethana ku policia nuk ka arsye për të dyshuar për personin, nuk lind asnjë shkelje. Për shembull:

*Shkelja për mos-informimit të personit në një ndalesë në rrugë, kur tashmë kishte dyshime ndaj tij për vjedhjen e naftës, për të drejtën e tij për heshtje dhe asistencë ligjore para se t'i parashtrihen pyetje lidhur me veprën, me ç'rast deklarata e tij përdorohet në gjykim,<sup>67</sup>*

*Shkelja për shkak të mosinformimit të një personi të marrë në pyetje në kontekstin e kërkesës për ndihmë të ndërsjellë ligjore nga një vend tjetër, ku ata nuk kishin statusin e një të dyshuari, për të drejtën e tij për të heshtur, pavarësisht nga fakti i ndihmës së ndërsjellë ligjore që zbulonte se kishte prova për të treguar se personi kishte kryer një vepër penale;<sup>68</sup>*

*Nuk ka shkelje kur një person, një nga të shumtët e marrë në pyetje si dëshmitar, vullnetarisht rrëfeu në mënyrë të plotë, dhe nuk i janë parashtruar pyetje të mëtejshme deri sa është pajisur me këshilla ligjore.<sup>69</sup>*

## C. DISPOZITAT RELEVANTE TË DIREKTIVËS

Dispozita kyçe këtu është neni 2(1), që përcakton fushën e zbatimit të direktivës *ratione personae dhe temporis*. Ky nen parasheh:

<sup>65</sup> *Bandeltov v. Ukraine*, përmendur më lartë shënimi 9, paragrafi 56

<sup>66</sup> Rasti i *Brusco v. France*, Nr. i ap. 1466/07 (Aktgjykimi i 14 tetorit 2010)

<sup>67</sup> *Zaichenko v. Russia*, përmendur më lartë shënimi 10

<sup>68</sup> *Stojkovic v. France and Belgium*, përmendur më lartë shënimi 10.

<sup>69</sup> *Bandeltov v. Ukraine*, përmendur më lartë shënimi 9.

'Kjo direktivë zbatohet nga momenti kur personat njoftohen nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar se dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një veprë penale deri në përfundimin e procedurës, që nënkupton përcaktimin përfundimtar të çështjes nëse i dyshuari ose i akuzuari ka kryer veprën penale, duke përfshirë, kur është e mundur, dënimin dhe zgjidhjen e çdo ankese' (theks i shtuar).

Gjithashtu, relevante janë edhe deklamimet 19 dhe 28 të direktivës, që parashohin:

'(19)(...) informacioni [për të drejtat procedurale] duhet të sigurohet menjëherë gjatë rrjedhës së procedurës dhe **më së largu para intervistës së parë zyrtare** të personit të dyshuar ose të akuzuar nga policia ose nga ndonjë autoritet tjetër kompetent.

(28) (...) Informacioni i ofruar për personat e dyshuar ose të akuzuar për veprën penale, të cilën dyshohen ose akuzohen se kanë kryer, duhet të ofrohet menjëherë, dhe **më së largu para intervistës së tyre të parë zyrtare** nga policia ose nga ndonjë autoritet tjetër kompetent (...)

Duhet gjithashtu të theksohet se secila prej dispozitave substanciale të direktivës imponon obligime ndaj shteteve anëtare në favor të "personave të dyshuar ose të akuzuar" (shih nenet 3(1), 4(1), 6(1) dhe 7(2)). Ky term nuk përcaktohet ndryshe.

## D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË

### 1. Pika paraprake: fushëveprimi i dukshëm i kufizuar i direktivës

#### a. Formulimi i nenit 2

Është menjëherë e dukshme nga formulimi i direktivës që neni 2 kërkon ta përcaktojë fushëveprimin e mbrojtjes duke iu referuar pikës kur një person "informohet" se është i dyshuar ose i akuzuar. Kjo ndodh veçanërisht në vazhden e referencave në deklamimet e "intervistës së parë zyrtare"; ndonëse këto terme nuk përcaktohen ndryshe, ato duket se sugjerojnë që të drejtat procedurale dhe akuzat duhet të njoftohen përpara marrjes zyrtare në pyetje.

Megjithatë, dispozita e fushëveprimit të direktivës, e cila nuk i referohet ligjit kombëtar, duhet të konsiderohet se kanë një kuptim autonom. Dhe dispozitat e direktivave duhet të interpretohen në përputhje me KEDNJ, si minimum. Garancia e nenit 6, siç e kemi parë, zbatohet nga pika ku interesat e një personi 'preken ndjeshëm' dhe kjo në mënyrë efektive do të thotë se, sipas termave të GJEDNJ-së, një person 'akuzohet' 'kur autoritetet e brendshme kanë arsye bindëse për të dyshuar se personi është përfshirë në një veprë penale'.<sup>70</sup>

Një lexim i ngushtë i direktivës do të çonte në situatën ku njerëzit të cilët, sipas termave të GJEDNJ-së, 'akuzohen në procedurë penale' nuk kanë mbrojtje sipas direktivës - pavarësisht faktit që direktiva synon të mbështetet në nenin 6 të KEDNJ-së. Direktiva do të privohej nga efekti i saj i dobishëm nëse shtetet anëtare do të ishin në gjendje të ngrinin

<sup>70</sup> Rasti i *Bandeltov v. Ukrain*, përmendur më lart shënimi 9, paragrafi 56.



procedime kundër njerëzve, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe megjithatë t'i shmangen detyrimeve që i imponohen atyre për t'i mbrojtur të drejtat e këtyre njerëzve.

## b. Pikëpamja e “Fair Trials” lidhur me fushëveprimin e direktivës

Prandaj, ne do të sugjeronim se ky është vetëm një rast i hartimit të kujdesshëm legjislativ dhe se një person i ‘akuzuar’ brenda kuptimit të nenit 6 të KEDNJ-së gëzon të drejta sipas direktivës. Një person bëhet ‘person i dyshuar ose i akuzuar’ që gëzon të drejtat sipas direktivës jo thjesht kur ligji kombëtar i cakton atyre statusin e të dyshuarit, por kurdo që interesat e tyre ‘preken ndjeshëm’ dhe në veçanti ‘kur autoritetet e brendshme kanë arsye bindëse për të dyshuar për përfshirjen e tij në një vepër penale’.

## 2. Përcaktimi i shkeljes

Në parim, qasja juaj këtu do të ndërlidhet me rrëfimet ose dëshmitë tjera të ofruara nga klienti para se të vendoset zyrtarisht nën dyshime. Kjo mund të jetë në një numër të procedurave të ndryshme (ndër ato që na janë përmendur janë ndalesa në rrugë, marrja joformale në pyetje në stacionin e policisë, marrja zyrtare në pyetje si dëshmitar dhe sigurimi i provave nën kompetenca të detyrueshme). Sapo të zbuloni se kjo dëshmi ka ndikim në procedurë (p.sh. justifikimi i hetimeve të mëtejshme, paraburgimi ose që mund të përdoret për dënim), duhet të veproni.

- Identifikoni deklaratat ose provat e tjera të ofruara jashtë kontekstit të hetimit formal të klientit si i dyshuar.
- Përcaktoni nëse ky informacion është dhënë tërësisht vullnetarisht ose nëse është marrë me qëllim që të përdoret kundër klientit tuaj.

Pasi të identifikoni deklaratën/dëshminë problematike, duhet të gjeni një bazë për të thënë se kjo është marrë në kundërshtim me direktivën për shkak të mos-informimit të individit për të drejtat e tij sipas nenit 3 dhe/ose të akuzave sipas nenit 6 të direktivës. Ju duhet të identifikoni, në mënyrë efektive, çështjet që dëshmojnë se personi kishte qenë nën dyshim në fazën kur dëshmia është marrë. Do të duket e logjikshme të kontrollohen gjërat që dalin nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së:

- Inspektoni dosjen e lëndës dhe identifikoni elementet objektive që nënkuptojnë që klienti ishte i dyshuar në kohën kur veprimi në fjalë ishte kryer, p.sh.:
- Dëshmitë e marra nga dëshmitarë/të dyshuar të tjerë, në posedim të autoriteteve hetimore, të cilat kanë akuzuar klientin; dhe
- Procedura e ndjekur (p.sh. procedura e detyrueshme për kthimin e dokumenteve) është bërë si një hap në një hetim penal kundër klientit.

Mbi këtë bazë, duhet të përcaktoni nëse direktiva është respektuar në atë kohë dhe, në veçanti, nëse klientit i janë ofruar informata në lidhje me akuzat dhe të drejtat e tij në përputhje me nenet 3 dhe 6 të direktivës.



- Përcaktoni nëse direktiva respektohet në kohën kur është marrë hapi përkatës:
- Nëse hapi është marrë me shkrim (p.sh. një njoftim që kërkon sigurimin e informacionit ose dokumenteve), inspektoni këtë dhe kontrolloni nëse ka përmbajtur ndonjë informacion lidhur me të drejtat procedurale ose akuzën;
  - Nëse hapi regjistrohet në procesverbalin e gjyqtarit, të policisë etj., kontrolloni nëse këto çështje përmenden; dhe
  - Bisedoni me klientin dhe pyesni atë lidhur me këtë. Nëse ai konfirmon se nuk i është dhënë ndonjë informacion, përdorni këtë dëshmi në mbështetje të kundërshtimit tuaj (më poshtë). Përveç kësaj, vendosni me klientin nëse do të kishte vepruar ndryshe nëse do të ishte këshilluar për të drejtat e tij.

### 3. Shqyrtoni ushtrimin e një mjeti ligjor

Lloji i kundërshtimit që do të bëni do të varet nga faza e procedurave në të cilat ju gjeni veten. Nëse është në fazën e procedurës paraprake, ju akoma mund të kërkonti parandalimin e akteve të mëtejshme hetimore, zbutjen e akuzave që bazohen në provat e siguruara më parë, ose mund të kërkonti që gjykata të mos marr parasysh ndonjë nga provat e mbledhura në bazë të shkeljes.<sup>71</sup> Sido që të jetë, ju jeni duke i bërë thirrje gjykatës për të siguruar efektin e direktivës:

- Referojuni direktivës para gjykatës kompetente.
- Direktiva zbatohet për “personat e dyshuar dhe të akuzuar” dhe zbatohet nga koha kur ata “akuzohen” në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo interpretohet nga GJEDNJ në kuptimin që një person akuzohet kur autoritetet kanë arsye bindëse për të besuar se personi ka kryer një vepër penale.
- Për arsyet e mëposhtme (p.sh. autoritetet kishin dëgjuar një dëshmitar tjetër që kishte denoncuar klientin), ky test ishte kaluar me sukses dhe ishte detyrë e autoriteteve që të njoftojnë “dëshmitarin” se ai ishte i dyshuar për një vepër penale dhe t’i siguronte informacionin e kërkuar sipas neneve 3 dhe 6 të direktivës.
- Për shkak të dështimit/vendimit për të vepruar në këtë mënyrë, klienti ka marrë vendime lidhur me sjelljen e mbrojtjes së tij (p.sh. ka bërë rrëfime, ka siguruar dokumente) pa kuptuar plotësisht pasojat e kësaj.
- Prandaj, për të siguruar efektivitetin e direktivës dhe për të mbrojtur drejtësinë e procedurës, gjykata duhet të korrigjojë çdo paragjykim të shkaktuar gjatë marrjes së vendimit të vet. Prandaj, ajo duhet të deklarojë çdo hap hetimor që ka themelin e vet në shkeljen e direktivës, të shpërfill çdo provë të marrë si rezultat i shkeljes së direktivës.
- Edhe nëse provat janë marrë para se personi të bëhet i dyshuar, gjykata duhet të sigurojë që vendimi i saj të jetë i lirë nga çdo kontaminim nga shkelja e direktivës, ndikimi i të cilit duhet të zhduket plotësisht.

<sup>71</sup> Shih Manualin ‘Përdorimi i së drejtës së BE-së në praktikë’ për më shumë diskutime mbi çështjen e mjeteve juridike.

## PËRFUNDIM

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në këtë temë është e plotë, por jo shteruese, dhe disa fusha kyçe nuk janë shqyrtuar. Kur lindin shkelje, kjo shpesh është pasojë e fakteve specifike të rasteve, prej të cilave nevojitet ekstrapolimi për të arritur në parimet udhëzuese. Direktiva, në vendosjen e standardeve të përbashkëta për të drejtën e informimit në procedurat penale, ofron një kornizë më të strukturuar normative brenda së cilës duhet të bëhet vendimmarrja dhe të kontrollohet në mënyrë gjyqësore.

"Fair Trials" shpreson se kjo direktivë mund të ndihmojë me të vërtetë mbrojtjen penale. Parimet e të drejtave themelore të BE-së në lidhje me qasjen në dokumente dhe respektimin e të drejtave të mbrojtjes kanë pasur ndikim të rëndësishëm, p.sh. duke detyruar zbulimin e informacioneve thelbësore në kontekstin e procedurave të sigurisë kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar që janë shumë kufizuese për të drejtat e mbrojtjes në rastin e fundit ZZ.<sup>72</sup> Ne shpresojmë që GJDBE do të japë gjykime të fuqishme në kontekstin penal në bazë të direktivës.

Në pritje të interpretimit të direktivës nga GJDBE, përgjatë këtij manuali, jemi munduar ta bëjmë të qartë kur kemi dhënë pikëpamjen ton sa i përket direktivës dhe jemi përpjekur të themi në mënyrë eksplicite prej nga ka ardhur qasja jonë ligjore. Megjithatë, ne pranojmë plotësisht se mund të ketë pikëpamje të tjera. Ju lutemi mos hezitoni të na jepni reagime kthyesë për këtë manual: na tregoni nëse e keni gjetur të dobishëm, nëse nuk pajtoheni dhe pse.

Gjithashtu ju inkurajojmë që të angazhoheni me "Fair Trials" dhe rrjetet që koordinojmë:

- Na kontaktoni për të na informuar për përvojën tuaj duke iu referuar direktivës.
- Na tregoni nëse gjykatat nxjerrin vendime pozitive duke zbatuar direktivat.
- Nëse lindin pyetje në lidhje me interpretimin, të kini parasysh rrugën e GJDBE-së: shikoni Manualin për përdorimin e të drejtës së BE-së, dokumentin tonë të vitit 2014 në lidhje me qasjet strategjike të GJDBE-së<sup>73</sup> dhe videon tonë të trajnimit online në lidhje me procedurën e vendimeve paraprake në praktikën penale.<sup>74</sup>
- Vizitoni rregullisht faqen tonë të internetit [www.fairtrials.org](http://www.fairtrials.org) për përditësime mbi zhvillimet kyçe në lidhje me direktivat, dhe lajmet për trajnimet individuale.
- Drejtohuni tek ne nëse nuk arrini ndokund me gjykatat, sepse ne mund të eksplorojmë mundësi të tjera si dërgimi i ankesave në Komisionin Evropian.
- Përfshihuni me shtyrjen para të çështjeve në kontekstin e vendor: shih dokumentin tonë të titulluar "*Towards an EU Defence Rights Movement*"<sup>75</sup> për ide konkrete në lidhje me artikujt, procedurat gjyqësore, konferencat etj.

Fair Trials Europe

Paneli Këshillimor i Ekspertëve Ligjorë

mars 2015

<sup>72</sup> Rasti C-300/11 ZZ [ECLI:EU:C:2013:363](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:62011C0363).

<sup>73</sup> Fair Trials, *Strategic approaches to litigation before the CJEU on the Roadmap Directives and EAW*, 2014, i qasshëm në <http://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/140818-CJEU-meeting-report.pdf>.

<sup>74</sup> E qasshme në <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/online-training/>.

<sup>75</sup> Fair Trials, *Strategies for implementation of the Roadmap Directives: Towards an EU Defence Rights Movement*, February 2015, i qasshëm në: <http://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/5A-IMPLEMENTATION-MOVEMENT-PAPER.pdf>.



Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Programit të Drejtësisë Penale të Komisionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fair Trials Europe dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë për t'i pasqyruar pikëpamjet e Komisionit Evropian.

